



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
GJYKATA KUSHTETUESE  
KOLEGJI I POSAÇËM I APELIMIT

Nr. 35/2019 regjistër (JR)  
Datë 31.07.2019

Nr. 24 i vendimit  
Datë 30.09.2020

**VENDIM**  
**NË EMËR TË REPUBLIKËS**

Trupi gjykues i Kolegjit të Posaçëm të Apelit, i përbërë nga gjyqtarët:

<b>Albana Shtylla</b>	<b>Kryesuese</b>
<b>Ina Rama</b>	<b>Relatore</b>
<b>Ardian Hajdari</b>	<b>Anëtar</b>
<b>Natasha Mulaj</b>	<b>Anëtare</b>
<b>Rezarta Schuetz</b>	<b>Anëtare</b>

– mori në shqyrtim në seancë gjyqësore në dhomë këshillimi, më datë 30.09.2020, ditën e mërkurë, në orën 10:00, në ambientet e Kolegjit të Posaçëm të Apelit, në prani të Vëzhgueses Ndërkombëtare Marie Tuma, me Sekretare Gjyqësore Adelajda Hiska, çështjen e Juridiksionit të Rivlerësimit që i përket:

**ANKUES:** Subjekti i rivlerësimit Ferdinand Elezi, prokuror në Prokurorinë pranë Gjykatës së Apelit Durrës.

**OBJEKTI :** Shqyrtimi i vendimit të Komisionit të Pavarur të Kualifikimit nr. 138, datë 09.04.2019.

**BAZA LIGJORE:** Kushtetuta e Republikës së Shqipërisë, neni F i Aneksit, neni 179/b. Ligji nr. 84/2016 “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, nenet 1, 2, 63 dhe 66, pika 1, germa “b”. Konventa Evropiane e të Drejtave të Njeriut, nenet 6, 7, 13, 14. Ligji nr. 44/2015 “Kodi i Procedurave Administrative të Republikës së Shqipërisë”. Ligji nr. 49/2012 “Për organizimin dhe funksionimin e gjykatave administrative dhe gjykimin e mosmarrëveshjeve administrative” i ndryshuar, neni 46.

**Trupi gjykues i Kolegjit të Posaçëm të Apelit,**

pasi shqyrtoi çështjen në tërësi, në përputhje me parashikimet e nenit 65 të ligjit nr. 84/2016 “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë” (në vijim “ligji nr. 84/2016”), shqyrtoi pretendimet e kërkimet e subjektit të rivlerësimit të paraqitura në ankim, i cili kërkoi përfundimisht ndryshimin e vendimit nr. 138, datë 09.04.2019, të Komisionit të Pavarur të

Kualifikimit dhe konfirmimin e tij në detyrë, dëgjoji gjyqtaren relatores Ina Rama, si dhe pasi e bisedoi atë,

## VËREN:

### I. Rrethanat e çështjes

1. Subjekti i rivlerësimit Ferdinand Elezi, në kohën e kryerjes së procesit të rivlerësimit nga Komisioni i Pavarur i Kualifikimit (në vijim “Komisioni”), ka mbajtur detyrën e prokurorit, në funksionin e drejtuesit të Prokurorisë pranë Gjykatës së Apelit Durrës dhe, në bazë të pikës 3 të nenit 179/b të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, i është nënshtruar procesit të rivlerësimit *ex-officio*. Në funksion të zhvillimit të procesit të rivlerësimit për subjektin e rivlerësimit Ferdinand Elezi (në vijim “subjekti i rivlerësimit”), Komisioni, bazuar në përcaktimet e neneve 33, 39 dhe 43 të ligjit nr. 84/2016, ka administruar raportet e hartuara nga institucionet: a) Inspektorati i Lartë i Deklarimit dhe Kontrollit të Pasurive dhe Konfliktit të Interesave (në vijim “ILDKPKI”); b) Drejtoria e Sigurimit të Informacionit të Klasifikuar (në vijim “DSIK”); dhe c) Grupi i Punës pranë Prokurorisë së Përgjithshme, sipas të cilave ka rezultuar:

1.1 ILDKPKI-ja, pasi kreu procedurën e kontrollit për vlerësimin e pasurisë së subjektit të rivlerësimit, në zbatim të nenit 33 të ligjit nr. 84/2016, dërgoi pranë Komisionit një raport<sup>1</sup> të hollësishëm dhe të arsyetuar, duke konstatuar se:

- deklarimi është i saktë në përputhje me ligjin;
- ka burime financiare të ligjshme për të justifikuar pasuritë;
- nuk ka kryer fshehje të pasurisë;
- nuk ka kryer deklarim të rremë;
- subjekti nuk gjendet në situatën e konfliktit të interesave.

1.2 DSIK-ja ka kryer kontrollin e figurës së subjektit të rivlerësimit, me anë të verifikimit të deklaramëve të subjektit të rivlerësimit dhe vlerësimit të të dhënave të tjera të përcjella prej agjencive ligjzbatuese, me qëllim që të identifikonte nëse subjekti i rivlerësimit kishte kontakte të papërshtatshme me personat e përfshirë në krimin e organizuar, sipas parimeve dhe kriterëve të parashikuara në nenin Dh të Aneksit të Kushtetutës dhe në ligjin nr. 84/2016. Për këtë qëllim, DSIK-ja ka dërguar raportin<sup>2</sup> në përputhje me nenin 39 të ligjit nr. 84/2016, ku ka konstatuar përshtatshmërinë për vazhdimin e detyrës si prokuror të subjektit të rivlerësimit.

1.3 Grupi i Punës në Prokurorinë e Përgjithshme, për kontrollin e aftësive profesionale të subjektit të rivlerësimit Ferdinand Elezi, ka hartuar një raport të hollësishëm dhe të arsyetuar, të cilin ia ka përcjellë Komisionit<sup>3</sup>.

Bazuar në nenin Ç, pika 1 e Aneksit të Kushtetutës dhe në nenin 4 të ligjit nr. 84/2016, Komisioni, pasi administroi raportet e vlerësimit të hartuara nga organet ndihmëse si më sipër, kreu procesin e rivlerësimit për subjektin e rivlerësimit Ferdinand Elezi, bazuar në të tria kriteret e vlerësimit: kontrolli i pasurisë, i figurës dhe vlerësimi i aftësive profesionale, duke marrë vendimin nr. 138, datë 09.04.2019.

<sup>1</sup> Raporti i ILDKPKI-së me nr. {\*\*\*} prot., datë 10.01.2018.

<sup>2</sup> Raporti i DSIK-së, i deklasifikuar me vendimin nr. {\*\*\*}, datë 20.07.2018.

<sup>3</sup> Raporti i Grupit të Punës së Prokurorisë së Përgjithshme nr. {\*\*\*} prot., datë 17.04.2018.

## II. Vendimi i Komisionit të Pavarur të Kualifikimit

2. Komisioni, me vendimin nr. 138, datë 09.04.2019, vendosi shkarkimin nga detyra të subjektit të rivlerësimit Ferdinand Elezi, me detyrë prokuror dhe drejtues në Prokurorinë pranë Gjykatës së Apelit Durrës. Ky vendim është marrë në përputhje me nenin 61, pika 3 e ligjit nr. 84/2016, bazuar në konkluzionet për kriterin e kontrollit të pasurisë si më poshtë.

### 2.1 Lidhur me kontrollin e pasurisë:

- Në lidhje me përlllogaritjen e kostos së jetesës, Komisioni e vlerëson të pabazuar kundërshtimin dhe pretendimin e paraqitur nga subjekti i rivlerësimit, pasi rezultoi të jetë aplikuar një kosto jetese minimale dhe standarde, për sa kohë ajo pasqyron minimumin e nevojshëm për një jetë të thjeshtë afër limiteve të mbijetesës.
- Nëse do të përlllogariteshin me shifra më reale dhe të segmentuara për çdo zë: ushqimi, faturat e energjisë elektrike, të ujit, të shërbimeve televizive, interneti, pastrimi dhe mirëmbajtja e banesave dhe e autoveturave, siguracionet e ndryshme, argëtimeve të mundshme (si p.sh., frekuentimi i restoranteve, bareve, hoteleve, udhëtimeve dhe pushimeve brenda vendit, palestra, shërbime për mirëmbajtje trupi), shpenzime të mundshme mjekësore/dentare etj. – sigurisht që do të arrinin në një shumëfish të shumës së përlllogaritur nga Komisioni për shpenzimet jetike për çdo familje të shtresës së mesme, kudo që ajo të ketë banuar.
- Për sa i përket mosdeklarimit të të ardhurave të bashkëshortes për vitin 2012 – nga shitja e pjesës takuese të pasurisë që është trajtuar më lart – ashtu si edhe për mospërputhjen e shifrave të pasqyruara ndër vite si fitime të realizuara nga aktiviteti i znj. B. (E.) P., siç është argumentuar në vendimin e Komisionit, ato vlerësohen dhe konsiderohen si deklarime të pamjaftueshme dhe të pasakta, sipas rastit, në përputhje me dispozitat ligjore.
- Gjithashtu, subjekti, pas dërgimit të rezultateve të hetimit nga Komisioni, ka pretenduar se diferenca pozitive e rezultuar nga analiza financiare në fund të vitit 2004 – e cila nuk është deklaruar në ILDKPKI nëpërmjet deklarimit të këtij viti, në rubrikën përkatëse, si një kursim i poseduar në gjendje cash – t'i merrej në konsideratë si gjendje likuiditetesh, pasi, sipas tij, këto kursime ai i kishte mbartur dhe i kishte përdorur në vitin 2005, vit në të cilin subjekti i rivlerësimit rezultoi me mungesë burimesh financiare.
- Komisioni nuk e mori në konsideratë këtë pretendim të subjektit, pasi detyrimi ligjor i subjekteve deklaruese për deklarimin e vlerës së likuiditeteve, gjendjes në cash etj. para fillimit të detyrës, si dhe në çdo vit, ndryshimet e ndodhura deri më 31 dhjetor të vitit paraardhës të interesave privatë, është detyrim i përcaktuar shumë qartë që në fillim, me hyrjen në fuqi të ligjit nr. 9049/2003 "Për deklarimin dhe kontrollin e pasurive, të detyrimeve financiare të të zgjedhurve dhe të disa nëpunësve publikë", botuar në Fletoren Zyrtare nr. 31, maj 2003.
- Komisioni, në pasqyrimin dhe përlllogaritjen e të ardhurave në fjalë, si për të gjitha subjektet dhe për të gjitha vitet e analizuara, i është referuar dokumentacionit të administruar gjatë hetimit administrativ dhe, në rastin konkret, për të ardhurat e subjektit u është referuar vërtetimeve të punësimit nga institucionet përkatëse, ndërsa lidhur me të ardhurat e bashkëshortes janë përdorur të dhënat e përcjella nga Drejtoria Tatimore.
- Lidhur me shpenzimet për udhëtimet e kryera, janë marrë në konsideratë dhe përlllogaritur shifrat sipas deklarimeve të subjektit, i cili ka pohuar se për vitin 2007 shpenzimet e udhëtimit kanë qenë 150000 lekë. Në të gjitha vitet kur subjekti ka deklaruar shifra të caktuara për shpenzimet për udhëtime, ato janë marrë në konsideratë në analizën financiare, pasi nuk kanë rezultuar më të vogla se shifrat minimaliste të paracaktuara.
- Në saje të rezultateve financiare të shpjeguara më lart, u konstatua një mungesë burimesh financiare të ligjshme në vlerën prej 3044.938 lekësh, në periudhën 2005 - 2016, që të mund të mjaftonin për të përballuar të gjitha shpenzimet e kryera nga familja e subjektit të rivlerësimit

*në periudhat respektive, si dhe për të realizuar kursimet e deklaruar. Për rrjedhojë, Komisioni vlerëson se, në prezencën e deklarimeve të pamjaftueshme dhe të mungesës së burimeve financiare të ligjshme për të justifikuar pasuritë dhe shpenzimet e kryera, duhet aplikuar neni D i Aneksit të Kushtetutës dhe pika 3 e nenit 61 të ligjit nr. 84/2016.*

Për sa më sipër, Komisioni lidhur me kriterin e pasurisë ka konkluduar se:

*Subjekti i rivlerësimit ka kryer deklarime të pamjaftueshme dhe nuk ka justifikuar në mënyrë bindëse burimin e ligjshëm të disa të ardhurave, lidhur me shumën më sipër, sipas parashikimeve të nenit D të Aneksit të Kushtetutës dhe pikës 3 të nenit 61 të ligjit nr. 84/2016, për rrjedhojë nuk arrin nivel të besueshëm në vlerësimin e pasurisë.*

**2.2** Për kontrollin e figurës, Komisioni ka konkluduar se *subjekti i rivlerësimit arrin një nivel të besueshëm, sipas germës “b” të nenit 59/1 të ligjit nr. 84/2016 dhe, për rrjedhojë, për sa i përket figurës, ai konsiderohet i përshtatshëm për vazhdimin e detyrës.*

**2.3** Për vlerësimin e aftësive profesionale, Komisioni ka konkluduar se *subjekti i rivlerësimit arrin, së paku nivelin minimal kualifikues të kërkuar, sipas germës “c” të nenit 59/1 të ligjit nr. 84/2016.*

**3.** Komisioni, pas shqyrtimit përfundimtar të çështjes, ka arritur në përfundimin se subjekti i rivlerësimit:

○ *nuk ka arritur një nivel besueshmërie, për sa i përket vlerësimit të pasurisë, sipas parashikimit të germës “a” të nenit 59/1 të ligjit nr. 84/2016.*

*Në këto kushte, Komisioni, bazuar në provat që disponon, vlerësimin e çështjes në tërësi, si dhe bindjen e brendshme, arrin në konkluzionin që subjektin të rivlerësimit, z. Ferdinand Elezi, me funksion prokuror dhe drejtues në Prokurorinë pranë Gjykatës së Apelit Durrës, t’i jepet masa disiplinore e shkarkimit nga detyra.*

### **III. Shkaqet e ankimit**

**4.** Subjekti i rivlerësimit, më datë 21.06.2019, ka paraqitur ankimin e tij ndaj vendimit nr. 138, datë 09.04.2019, të Komisionit, ankim i cili është pranuar nga Komisioni me vendimin nr. 138/1, datë 25.06.2019.

**5.** Nëpërmjet ankimit, subjekti i rivlerësimit kërkon nga trupi gjykues i Kolegjit të Posaçëm të Apelit (në vijim “trupi gjykues i Kolegjit” ose “Kolegji”) që të shqyrtojë çështjen duke e gjykuar atë në seancë gjyqësore publike, për çmuarjen e plotë dhe të saktë të të gjitha provave të administruara nga Komisioni dhe të atyre të kërkuara prej tij, kërkesë e cila lidhet drejtpërdrejt me shkaqet të cilat nga Komisioni janë vlerësuar në mënyrë të gabuar, me qëllimin që pas vlerësimit të tyre Kolegji të vendosë për ndryshimin e vendimit nr. 138, datë 09.04.2019, të Komisionit të Pavarur të Kualifikimit për subjektin e rivlerësimit Ferdinand Elezi dhe konfirmimin e tij në detyrë.

**6.** Nga shqyrtimi tërësor i ankimit dhe i parashkrimeve të subjektit të rivlerësimit Ferdinand Elezi ndaj vendimit të Komisionit nr. 138, datë 09.04.2019, si shkaqe të ankimit janë evidentuar në mënyrë të përmbledhur si më poshtë.

*A. Shkaqet e ankimit mbi procesin e rregullt ligjor, si dhe aplikimin e ligjit material*

**6.1** Në vendimin e Komisionit nr. 138, datë 09.04.2019, si dhe në procedurën e zhvilluar gjatë hetimit administrativ, janë cenuar një sërë parimesh të procesit të rregullt ligjor, si: (i) shkelja e parimit të kontradiktorialitetit, barazisë së palëve dhe gjykimit në seancë publike gjatë procesit të

hetimit administrativ; (ii) në seancën dëgjimore të zhvilluar nga Komisioni, subjekti i rivlerësimit nuk ka pasur mundësi për të kundërshtuar konstatimet dhe vlerësimet e referuara nga komisioneri relator, pasi prej tij u shpjegua se provat e paraqitura nga subjekti i rivlerësimit do të vlerësoheshin pas përfundimit të seancës dëgjimore, para dhënies së vendimit; (iii) Komisioni nuk pranoi të vlerësojë konkluzionet e aktit të ekspertimit të ekspertit financiar, gjë e cila ka passjellë që Komisioni të bazojë vendimmarrjen vetëm në analizën financiare të këshilltarit ekonomik, të cilën për më tepër nuk ia ka njoftuar subjektin, duke shkelur jo vetëm parimin e barazisë së palëve, por edhe atë të kontradiktorialitetit e barazisë së armëve; (iv) vendimmarrjes së Komisionit, të dhënë me vendimin nr. 138, datë 09.04.2019, i mungon objektiviteti dhe proporcionaliteti për të cilin ka urdhëruar neni 52, pika 2 e ligjit nr. 84/2016; (v) Komisioni ka shkelur parimin e një procesi të rregullt ligjor duke paragykuar çështjen dhe duke paracaktuar vendimin; (vi) me vendimin e Komisionit është shkelur parimi i shtetit të së drejtës dhe i sigurisë juridike (neni 7 i KEDNj-së); (vii) me vendimmarrjen e Komisionit, subjektin të rivlerësimit i është cenuar e drejta për t'u gjykuar nga një gjykatë e pavarur dhe e paanshme; (viii) Kushtetuta dhe ligji nr. 84/2016 cenojnë të drejtën për një ankim efektiv, duke cenuar nenin 13 të KEDNj-së.

**6.2** Komisioni nuk mund të bazojë vendimmarrjen për dhënien e masës disiplinore në interpretimin në të kundërt – të nenit 59 të ligjit nr. 84/2016 – pasi kjo dispozitë titullohet “konfirmimi në detyrë”; gjithashtu Komisioni nuk ka konsideruar se masa disiplinore e shkarkimit nga detyra jepet kur nga hetimi administrativ i kryer rezulton se subjekti i rivlerësimit ka më shumë se dyfishi i pasurisë së ligjshme sipas nenit 61, pika 1 e ligjit nr. 84/2016 apo kur ndodhet në kushtet e pikës 3 të nenit 61, kur rezulton se subjekti i rivlerësimit në mënyrë kumulative ka bërë deklaram të pamjaftueshëm për kriteret e kontrollit të figurës dhe të pasurisë.

**6.3** Subjekti i rivlerësimit paraqet kundërshtime lidhur me vlerën që i jepet raportit të ILDKPKI-së gjatë procesit të rivlerësimit.

**6.4** Subjekti i rivlerësimit pretendon se vendimi i Komisionit rezulton i pambështetur në dispozitat e Aneksit të Kushtetutës, ligjin e posaçëm nr. 84/2016, si dhe në kuadrin ligjor shoqëruar për sa i përket ligjshmërisë dhe saktësisë së deklaramit të pasurisë.

#### *B. Shkaqet e ankimit që lidhen me vlerësimin e kriterit të pasurisë*

**6.5** Subjekti i rivlerësimit parashtron se vendimmarrja për kontrollin e pasurisë është rezultat i mosvlerësimit apo çmuarjes së gabuar të provave të administruara nga Komisioni dhe mosmarrjes në konsideratë të të gjitha provave të sjella nga subjekti i rivlerësimit pas kalimit të barrës së provës, pasi: (i) nuk janë përllogaritur të plota të ardhurat nga paga e subjektit të rivlerësimit; (ii) nuk janë përllogaritur të ardhurat nga paga e bashkëshortes si subjekt i vetëpunësuar, për të cilën janë paguar detyrimet tatimore; (iii) Komisioni nuk ka vlerësuar konkluzionet *shkencore* të arritura nga akti i ekspertimit; (iv) shpenzimet për jetesë dhe udhëtimet janë përllogaritur mjaft të larta në krahasim me ato që kanë qenë faktikisht, dhe nuk rezultojnë të njëjta me ato të aplikuara nga ILDKPKI-ja apo të dhënat e INSTAT-it, duke konsideruar ndër vite përbërjen familjare të subjektit të rivlerësimit.

**6.6** Qëndrimi i ndryshëm dhe diskriminues, në dëm të subjektit të rivlerësimit, i mbajtur nga Komisioni në përllogaritjen e shpenzimeve jetike e udhëtimeve, rezulton të jetë i tillë, referuar edhe qëndrimeve të *vetë* Komisionit në vendimmarrje të mëparshme.

**6.7** Analiza financiare vit pas viti, e kryer nga Komisioni, është e pasaktë, pasi në të janë përllogaritur më pak të ardhurat e subjektit të rivlerësimit dhe të bashkëshortes, ndërsa shpenzimet e

jetesës dhe në udhëtim janë rritur në mënyrë artificiale, gjë që vërehet kryesisht në analizën që u përket viteve 2005, 2007, 2008, 2010, 2013, 2014 dhe 2016.

**6.8** Në lidhje me analizën financiare të viteve 2003-2016, Komisioni nuk ka respektuar parimin e kontradiktorialitetit midis palëve në procesin e hetimit administrativ dhe atë të gjykimit në seancë publike.

**6.9** Referuar mënyrës së përlllogaritjes së shpenzimeve jetike dhe për udhëtim, Komisioni ka dhënë një vendim të paarsyetuar për subjektin e rivlerësimit, si dhe ka shkelur parimin e procesit të rregullt ligjor që cenon standardin e arsytimit të vendimit, parimin e barazisë dhe të mosdiskriminimit, si dhe parimin e sigurisë juridike.

#### **IV. Vlerësimi i Kolegjit të Posaçëm të Apelimit**

##### **A. Procesi gjyqësor në Kolegjin e Posaçëm të Apelimit**

7. Ankimi i subjektit të rivlerësimit ndaj vendimit të Komisionit nr. 138, datë 09.04.2019, u mor në shqyrtim në Kolegj në dhomë këshillimi, në përputhje me nenin 65 të ligjit nr. 84/2016 dhe nenin 49 të ligjit nr. 49/2012 “Për organizimin dhe funksionimin e gjykatave administrative dhe gjykimin e mosmarrëveshjeve administrative”, i ndryshuar (në vijim “ligji nr. 49/2012 i ndryshuar”).

**7.1** Në ankim, subjekti i rivlerësimit ka kërkuar gjykimin e çështjes në seancë gjyqësore publike, për çmuarjen e plotë dhe të saktë të të gjitha provave të administruara nga Komisioni dhe atyre të kërkuara prej tij. Sipas tij, kjo kërkesë lidhet drejtpërdrejt me shkaqet të cilat nga Komisioni janë vlerësuar në mënyrë të gabuar, duke sjellë aplikimin e masës disiplinore të shkarkimit nga detyra të subjektit të rivlerësimit.

**7.2** Trupi gjykues i Kolegjit, në shqyrtim të këtij pretendimi të subjektit për të gjykuar këtë çështje në seancë gjyqësore publike, në analizë të të gjitha konkluzioneve të paraqitura në vendimin e Komisionit dhe pretendimeve të parashtruara në ankimin e subjektit të rivlerësimit, nuk evidentoi ndonjë shkelje procedurale apo konstatim të gabuar të situatës faktike, në kuptim të nenit 51, pika 1, germa “b” e ligjit nr. 49/2012, të tilla që do të sillnin nevojën e debatit gjyqësor për shërimin e tyre, siç subjekti i rivlerësimit pretendon. Gjithashtu Kolegji, kryesisht në funksion të kërkesave të nenit 51, pika 1 e ligjit nr. 49/2012, vlerësoi se: a) konstatimi i gjendjes faktike nga Komisioni është bërë në mënyrë të plotë dhe të saktë dhe, për pasojë, nuk nevojitet vërtetimi i fakteve të reja dhe marrja e provave të reja; b) nuk konstatoi shkelje të rënda procedurale që të kenë ndikuar në vendimmarrje apo gjendje faktike të konstatuara gabim dhe në mënyrë jo të plotë nga Komisioni; c) nuk është e nevojshme përsëritja e marrjes së disa apo të gjitha provave të administruara në Komision.

**7.3** Në këto rrethana, trupi gjykues i Kolegjit çmoi se çështja mund të zgjidhej në gjendjen që janë aktet e administruara gjatë hetimit administrativ, prandaj vendosi që gjykimi të zhvillohej në dhomë këshillimi, konform përcaktimeve të nenit 65 të ligjit nr. 84/2016, që referon te zbatimin e nenit 49 të ligjit nr. 49/2012.

##### **B. Shqyrtimi i shkaqeve të ankimit që lidhen me procesin e rregullt ligjor, si dhe aplikimin e ligjit**

8. Në lidhje me pretendimet e subjektit të rivlerësimit, të shtjelluara me hollësi në paragrafët nga 6.1 deri të 6.4 më sipër, që lidhen me procesin e rregullt, Kolegji konstaton se:

**8.1** Pretendimet e subjektit të rivlerësimit për këto elemente – siç do të analizohen në mënyrë më të detajuar më poshtë – lidhen kryesisht me analizën ekonomike. Subjekti i rivlerësimit parashtron se analiza ekonomike e Komisionit nuk detajon kostot për shpenzimet e jetesës kundrejt atyre të udhëtimeve, pasi këto dy kategori janë përlllogaritur se bashku. Kjo mënyrë përlllogaritjeje, sipas subjektit të rivlerësimit, e pamundëson mbrojtjen nga ana e tij dhe, për pasojë, është e padrejtë.

**8.2** Në analizë të këtij pretendimi të subjektit dhe dokumentacionit në fashikull, Kolegji vëren se analiza e kryer nga Komisioni përfshin kostot e udhëtimit dhe të jetesës në një grupim të përbashkët.

**8.3** Për rrjedhojë, për t'i garantuar subjektit të rivlerësimit të drejtën për të pasur një analizë alternative në funksion të pretendimeve të tij në ankim, trupi gjykues i Kolegjit kreu një analizë të re financiare, bazuar në aktet e administruara gjatë hetimit administrativ, por mbi bazën e metodologjisë për përlllogaritjen e kostove për shpenzimet e udhëtimeve<sup>4</sup>, si dhe për atë të shpenzimeve të jetesës<sup>5</sup>, tashmë të aplikuar me subjektet e tjera të rivlerësimit. Në zbatim të garancive të procesit të rregullt ligjor, kryerja e analizës financiare nga Kolegji ka pasur, së pari, si synim, të rishikojë vendimin e Komisionit nga ana procedurale dhe, së dyti, krijimin e një fotografie të qartë të kontrollit të pasurisë për subjektin, parë në kontekstin e pretendimeve të tij në ankim. Analiza financiare gjendet në pjesën vijuese të këtij vendimi, në paragrafët 11-19.

**8.4** Në përfundim, në kushtet kur pretendimet e subjektit të rivlerësimit me natyrë procedurale janë kryekëput të lidhura me mënyrën e përlllogaritjes së kostove të jetesës, trupi gjykues vendosi të gjykojë mbi bazë aktesh në dhomë këshillimi. Po ashtu, për të njëjtën arsye, në analizë të pretendimeve të subjektit të rivlerësimit, trupi gjykues konstatoi se nuk gjente zbatim asnjë nga kushtet e nenit 51, pika 1 e ligjit nr. 49/2012 për zhvillimin e seancës publike<sup>6</sup>. Konkretisht, trupi gjykues i Kolegjit nuk konstatoi nevojën për të vërtetuar fakte të reja, shkelje procedurale të rënda apo se nevojitet përsëritja e marrjes së provave. Së fundmi, përgjatë të gjithë hetimit administrativ në Komision, subjekti i rivlerësimit, përveçse ka paraqitur një analizë financiare nëpërmjet një akt-ekspertimi të ekspertit auditues<sup>7</sup>, ka pasur mundësitë të paraqiste akte e shpjegime lidhur me analizën financiare, e njëkohësisht, me ankimin nuk ka sjellë asnjë provë të re, e cila plotëson kushtet e parashikuara nga neni 47<sup>8</sup> i ligjit nr. 49/2012 .

9. Subjekti i rivlerësimit pretendon se Komisioni nuk mund të bazojë vendimmarrjen për dhënien e masës disiplinore në interpretimin “në të kundërt” të nenit 59 të ligjit nr. 84/2016, pasi kjo

---

<sup>4</sup> Shiko vendimin e Kolegjit nr. 11/2019 (JR), datë 22.05.2019.

<sup>5</sup> Shiko vendimet e Kolegjit nr. 20/2019 (JR), datë 31.07.2019; nr. 9/2020 (JR), datë 26.06.2020.

<sup>6</sup> Neni 51, pika 1 e ligjit nr. 49/2012, ndryshuar me ligjin 100/2014, parashikon: “[1]. Gjykata, në dhomë këshillimi, vendos shqyrtimin e çështjes në seancë gjyqësore me praninë e palëve, në rast se çmon se debati gjyqësor është i nevojshëm për të vlerësuar se: a) për konstatimin e gjendjes faktike në mënyrë të plotë dhe të saktë, duhen vërtetuar fakte të reja dhe duhen marrë prova të reja kur janë kushtet e nenit 47 të këtij ligji; b) vendimi kundër të cilit është paraqitur ankimi është bazuar në shkelje të rënda procedurale, apo në gjendjen faktike të konstatuar gabimisht ose në mënyrë jo të plotë; c) me qëllim të konstatimit të drejtë të gjendjes faktike duhet të përsërisë marrjen e disa ose të gjitha provave të marra nga gjykata e shkallës së parë [...]”.

<sup>7</sup> Pasi është njohur me Rezultatet Paraprake të Hetimit të Komisionit, së bashku me shpjegimet e tij mbi këto rezultate, më datë 21.03.2019, subjekti i rivlerësimit ka paraqitur edhe një akt ekspertimi nga audituesi, z.B. B., me pretendimet e tij në lidhje me analizën financiare për çështjet e ngritura nga Komisioni në drejtim të kontrollit të pasurisë. Ky akt ekspertimi është administruar nga Komisioni dhe është pjesë e fashikullit të përcjellë me ankimin në Kolegji.

<sup>8</sup> Neni 47 i ligjit nr. 49/2012 parashikon: “Në ankim nuk mund të paraqiten fakte të reja dhe të kërkohen prova të reja, përveçse kur ankuesi provon se pa fajin e tij nuk ka mundur t'i paraqesë këto fakte ose t'i kërkojë këto prova në shqyrtimin e çështjes në gjykatën administrative të shkallës së parë, në afatet e parashikuara në këtë ligj.”

*dispozitë i dedikohet konfirmimit në detyrë; prej Komisionit nuk është konsideruar se masa disiplinore e shkarkimit nga detyra jepet kur nga hetimi administrativ i kryer rezulton se subjekti ka më shumë se dyfishi i pasurisë së ligjshme sipas nenit 61, pika 1 e ligjit nr. 84/2016 apo në kushtet e pikës 3 të nenit 61, kur nga hetimi rezulton se subjekti në mënyrë kumulative ka bërë deklaram të pamjaftueshëm për kriteret e kontrollit të figurës dhe pasurisë.*

**9.1** Lidhur me këto pretendime, trupi gjykues i Kolegjit konstaton se vendimi i Komisionit në pjesën e konkluzioneve të tij mbi procesin e rivlerësimit të subjektit Ferdinand Elezi, ka vendosur: [...] Lidhur me kriterin e pasurisë, subjekti i rivlerësimit ka kryer deklarime të pamjaftueshme dhe nuk ka justifikuar në mënyrë bindëse burimin e ligjshëm të disa të ardhurave, lidhur me shumën e specifikuar më sipër, sipas parashikimeve të nenit D të Aneksit të Kushtetutës dhe pikës 3 të nenit 61 të ligjit nr. 84/2016, për rrjedhojë nuk arrin nivel të besueshëm në vlerësimin e pasurisë [...]. Ndërsa në pjesën arsyetuese të vendimit, në përfundim të kontrollit të pasurisë, Komisioni<sup>9</sup> ka konkluduar se: [...] Komisioni vlerëson se, në prezencën e deklarimeve të pamjaftueshme dhe të mungesës së burimeve financiare të ligjshme për të justifikuar pasuritë dhe shpenzimet e kryera, duhet aplikuar neni D i Aneksit të Kushtetutës dhe pika 3 e nenit 61 të ligjit nr. 84/2016 [...].

Nga sa më sipër, është e qartë se në vlerësimin e Komisionit, në drejtim të kontrollit të pasurisë, subjekti i rivlerësimit është konstatuar të jetë në kushtet e mungesës së burimeve të ligjshme për të justifikuar pasuritë dhe mbuluar shpenzimet e kryera në vitet kur ka rezultuar me situatë financiare negative. Trupi gjykues i Kolegjit çmon se, nisur nga përmbajtja e arsyetimit të Komisionit, ku përcaktohet se pas analizës financiare subjekti i rivlerësimit rezulton me mungesë të burimeve të ligjshme, mungesa e referencës në dispozitën ligjore, në këtë rast neni 33, pika 5, germa “b” e ligjit nr. 84/2016, që passjell konstatimin për deklaram të pamjaftueshëm për shkak të mungesës së burimeve financiare të ligjshme, nuk e bën vendimin të pakuptueshëm në drejtim të konstatimeve që kanë dalë nga hetimi administrativ i zhvilluar në Komision për procesin e rivlerësimit të subjektit të rivlerësimit Ferdinand Elezi. Po ashtu, vendimi rezulton i qartë edhe për shkeljet e konstatuara për mungesë të burimeve të ligjshme dhe qëndrimet e mbajtura prej Komisionit në gjetjet në këtë drejtim, të përshkruara në pjesën arsyetuese të vendimit.

**9.2** Lidhur me pretendimin tjetër të subjektit të rivlerësimit, se nga hetimi administrativ ka rezultuar që ai nuk ka më shumë se dyfishi i pasurisë së ligjshme, trupi gjykues i Kolegjit konstaton se Komisioni argumenton se subjekti i rivlerësimit, ndër vite, ka pasur mungesë të të ardhurave të ligjshme për krijimin e pasurisë dhe për mbulimin e kostove të jetesës. Në *asnjë* pjesë të vendimit të Komisionit nuk ka mbahet qëndrim se pasuria e subjektit të rivlerësimit është më shumë se dyfishi i pasurisë së ligjshme.

Trupi gjykues i Kolegjit në vijim do të analizojë në mënyrë të detajuar shkaqet e ankimit që lidhen me pasurinë, duke i dhënë në këtë mënyrë përgjigje edhe pretendimit të subjektit të rivlerësimit lidhur me saktësimin e vlerës së mungesës së burimeve të ligjshme financiare. Ndërkohë, pavarësisht prej analizës në vijim, Kolegji vlerëson se pretendimi i subjektit të rivlerësimit se pasuria e tij nuk është sa dyfishi i pasurisë së ligjshme dhe, si e tillë, nuk duhet të përbëjë shkak për shkarkim, është i pabazuar dhe, si rrjedhojë, pa ndikim në zgjidhjen e çështjes, për sa kohë që kjo situatë ligjore nuk ka përbërë shkak për shkarkimin e subjektit të rivlerësimit. Komisioni ka konkluduar për mungesë të burimeve të ligjshme për krijimin e pasurisë, duke e kualifikuar situatën sipas parashikimit të nenit 61, pika 3 e ligjit nr. 84/2016, dhe jo sipas nenit 61, pika 1 që parashikon sanksionin për rastet në të cilat vërtetohet *dyfishi* i pasurisë së ligjshme.

---

<sup>9</sup> Në paragrafin xxvi, faqe 21 të vendimit të Komisionit nr. 138, datë 09.04.2019.



**9.3** Në ankim, subjekti i rivlerësimit paraqet pretendime lidhur me vlerën që i jepet raportit të ILDKPKI-së gjatë procesit të rivlerësimit, duke sjellë në vëmendje parashikimet e nenit 33 të ligjit nr. 84/2016, mbi bazën e të cilave procedura e kontrollit pasqyrohet në një raport<sup>10</sup> të hollësishëm dhe të arsyetuar, duke konkluduar se deklarimi i subjektit të rivlerësimit lidhur me pasurinë, është i saktë e në përputhje me ligjin. Sipas subjektit të rivlerësimit, me qëllim përcaktimin e gjendjes së fakteve dhe rrethanave që kanë të bëjnë me konstatimin e gjendjes faktike, nëse gjatë hetimit faktet rezultojnë ato që janë përshkruar në deklaratën *vetting* dhe janë konstatuar nga ILDKPKI-ja, Komisioni parimisht nuk mund të mbajë një qëndrim të ndryshëm, pasi kjo do të ishte në kundërshtim me provat.

**9.3.1** Duke arsyetuar mbi peshën e raportit të ILDKPKI-së në procesin e rivlerësimit, subjekti i rivlerësimit parashtron se: “[...] edhe në versionin që pranojmë se Komisioni ka mundësi të mbajë një qëndrim të ndryshëm për kriterin e pasurisë nga ai i mbajtur nga ILDKPKI, atëherë parimisht Komisioni ka detyrimin që të argumentojë hollësisht dhe në mënyrë të plotë se ku e bazon një qëndrim të tillë dhe përse nuk e vlerëson të besueshëm raportin e ILDKPKI-së [...]”.

**9.3.2** Në vijim, subjekti i rivlerësimit parashtron se me hetimin e kryer, Komisioni nuk ka mundur të gjejë fakte të reja lidhur me pasurinë, përtej asaj të deklaruar në deklaratën *vetting*. Në këto kushte, nuk është justifikuar përse Komisioni ka dalë në konkluzion të ndryshëm nga ILDKPKI-ja lidhur me pasurinë dhe mbi ç’bazë u konkludua për deklarim të pasaktë lidhur me kontrollin e pasurisë.

**9.3.3** Trupi gjykues i Kolegjit i gjen pretendimet e subjektit të rivlerësimit mbi vlerën përfundimtare të raportit të ILDKPKI-së, në kuadër të procesit të rivlerësimit, në kontradiktë me përcaktimet e Kushtetutës, ligjit nr. 84/2016, si dhe me vendimin e Gjykatës Kushtetuese nr. 2/2017. Në zbatim të nenit 50 të ligjit nr. 84/2016, institucionet e rivlerësimit hetojnë dhe vlerësojnë të gjitha faktet dhe rrethanat e nevojshme për procedurën e rivlerësimit dhe gjatë hetimit administrativ mund të kërkojnë informacion. Sipas së njëjtës dispozitë, institucionet e rivlerësimit kanë akses të gjerë në informacion të ruajtur nga ente publike dhe private në drejtim të kontrollit të secilit prej kritereve të rivlerësimit, që përfshin dosjet personale, pasuritë, gjendjen gjyqësore, transaksionet bankare, kalimin e kufirit dhe të tjera të dhëna, ndër të tjera. Këtij aksesit të institucioneve të rivlerësimit i korrespondon detyrimi i entiteteve publike dhe private për të vënë në dispozicion informacionin e disponuar brenda një afati të caktuar kohor. Ligji parashikon edhe pasoja në rast mungese bashkëpunimi. Me fjalë të tjera, në ngritjen e procesit të rivlerësimit, ligjvënësi i ka kushtuar kujdes të veçantë rëndësisë së hetimit nga institucionet e rivlerësimit, përfshirë edhe Komisionin, për të siguruar saktësinë e informacionit dhe për të garantuar të drejtat e subjekteve të rivlerësimit në funksion të misionit të procesit – kthimit të besimit të publikut te sistemi i drejtësisë. Sa më sipër, zbatuar në rrethanat e hetimit administrativ, parashikohet që Komisioni ka tagrin që, pavarësisht rezultateve të hetimit të kryer nga autoritetet e pavarura, të kryejë verifikime dhe hetime të mëtejshme për të vërtetuar çdo indicie apo të dhënë që rezultojnë nga dokumentacioni i mbledhur gjatë procesit. Ky pretendim i subjektit të rivlerësimit, përveçse i pabazuar në ligj, duket se bazohet në një interpretim alogjik të nenit 50 të ligjit nr. 84/2016, sipas të cilit procesi i rivlerësimit duhet të reduktohet në mbledhje raportesh nga institucionet e pavarura apo ndihmëse, për të kryer hetim të pavarur. Kjo dispozitë është interpretuar gjerësisht nga Gjykata Kushtetuese në vendimin nr. 2/2017, ku është mbajtur qëndrimi që Komisioni ka tagrin që, pavarësisht rezultateve të hetimit të kryer nga autoritetet e pavarura, të kryejë verifikime dhe hetime

<sup>10</sup> Raporti i ILDKPKI-së, përcjellë në Komision me shkresën nr. {\*\*\*} prot., datë 10.01.2018.

të të gjitha fakteve dhe rrethanave të nevojshme për procedurën e rivlerësimit, për të vërtetuar çdo indicie apo të dhënë që rezultojnë nga dokumentacioni i mbledhur gjatë procesit<sup>11</sup>.

**9.3.4** Edhe më tej, Gjykata Kushtetuese, sa i përket rëndësisë së hetimit të pavarur nga Komisioni, ka të arsyetuar:

*[...] 4.5 Në lidhje me procesin e kontrollit të pasurisë, parashikimi në nenin 33/1 të ligjit është në përputhje me parashikimin e pikës 2 të nenit D të Aneksit të Kushtetutës. Pretendimi se termi “kontroll” që përdor Kushtetuta është për kontroll sipërfaqësor prima facie, është interpretim abuziv i normës kushtetuese. Nëse kushtetutëbërësi do të kishte dashur ta kufizonte kontrollin vetëm në mënyrë sipërfaqësore, do ta kishte bërë atë shprehimisht. Ligji në asnjë rast nuk mohon të drejtën dhe kompetencën e organeve të rivlerësimit për të kryer vetë verifikime, çka mund ta bëjnë kryesisht ose nëse krijojnë bindjen se hetimi i ILDKPKI-së nuk ka qenë i plotë dhe i saktë. Kushtetuta e ka bërë të qartë se marrëdhënia mes ILDKPKI-së dhe KPK-së është një marrëdhënie bashkëpunimi, për shkak se ILDKPKI-ja është një organ i specializuar dhe puna e saj e finalizuar me një raport, ndihmon punën e organeve të rivlerësimit. Procedura e parashikuar nga Kushtetuta dhe nga ligji jo vetëm nuk cenon të drejtën për një proces të rregullt, por krijon mundësi për një proces të rregullt dhe efektiv, ku organi i specializuar i monitorimit ose i kontrollit jep një raport që vlerësohet në mënyrë të ndarë nga një organ administrativo-gjyqësor, sikurse KPK-ja, dhe një organ gjyqësor, sikurse KA-ja [...].*

**9.4** Subjekti i rivlerësimit pretendon se, edhe nëse pranohet se Komisioni ka kompetencë të kryejë një kontroll të pavarur të pasurisë, gjithsesi nuk mund të arrijë në një konkluzion të ndryshëm nga ILDKPKI-ja, pasi do të ishte në kundërshtim me provat. Trupi gjykues i Kolegjit, në analizë dhe pa përsëritur sa është shtjelluar më sipër në paragrafin 9.3 (dhe nënparagrafët e tij), vëren se ky pretendim i subjektit të rivlerësimit është i pabazuar në ligj, duke sjellë në vëmendje gamën e gjerë të të dhënave dhe shpjegimeve që Komisioni dhe Kolegji administrojnë si pasojë e përgjigjeve në pyetësorë apo elemente shpenzimesh, si ato të udhëtimeve, për të cilat ILDKPKI-ja nuk ka dijeni. Për këto arsye, edhe në situatën e rrethanave konkrete, Kolegji gjithashtu konstaton se nëse krahasojmë të dhënat e raportit të ILDKPKI-së me ato të hetimit administrativ të Komisionit, vihet re se hetimi i Komisionit është më i detajuar dhe është rezultat i të dhënave të tjera të mbledhura gjatë hetimit e nëpërmjet shpjegimeve të subjektit – të tilla si shpenzimet e udhëtimit apo të mobilimit, ndër të tjera.

**9.5** Në vijim të këtij arsyetimi, nga ana tjetër, referuar edhe arsyetimit të vendimit nr. 2/2017 të Gjykatës Kushtetuese, si dhe jurisprudencës<sup>12</sup> së deritanishme të Kolegjit, pretendimet e subjektit të rivlerësimit lidhur me mungesën e bazueshmërisë së analizës financiare të kryer nga Komisioni apo vlerën përfundimtare të raportit të ILDKPKI-së në procesin e rivlerësimit, trupi gjykues i Kolegjit i konsideron të pabazuara në ligj.

---

<sup>11</sup>Shih paragrafët 32 dhe 38 të vendimit nr. 2/2017 të Gjykatës Kushtetuese, në: [http://www.gjk.gov.al/web/Lista\\_e\\_Vendimeve\\_92\\_1.php](http://www.gjk.gov.al/web/Lista_e_Vendimeve_92_1.php). Për të njëjtin qëndrim të Kolegjit, shih, ndër të tjera, edhe paragrafin 45 të vendimit JR 06/2020, datë 18.06.2020: <http://kpa.al/wp-content/uploads/2020/09/Vendim-i-arsyetuar-i-anonimizuar-SR-Alltun-%C3%87ela-per-web.pdf> si dhe, ndër të tjera, vendimet e Kolegjit nr. 30/2019 (JR), datë 18.11.2019, nr. 28/2019(JR), datë 30.10.2019.

<sup>12</sup> Shih edhe vendimet e Kolegjit nr. 13/2020 (JR), datë 08.07.2020; nr. 9/2020 (JR); datë 26.06.2020 dhe nr. 3/2020 (JR), datë 04.03.2020.

10. *Subjekti i rivlerësimit pretendon se vendimi i Komisionit rezulton i pambështetur në dispozitat e Aneksit të Kushtetutës, ligjin e posaçëm nr. 84/2016, si dhe kuadrin ligjor shoqëruar për sa i përket ligjshmërisë dhe saktësisë së deklaramit të pasurisë.*

**10.1** Sipas subjektit, vërtetësia dhe saktësia e deklarameve në kuadër të këtij procesi rivlerësimi, duhet të lidhen vetëm me kontrollin e deklaramës *vetting* dhe jo me ato të deklaramave të mëparshme të pasurisë. Nëse objekt kontrolli do të ishin edhe deklaramat e mëparshme, ligji nuk kishte arsye të kërkonte hartimin e një deklaramë të re nga subjektet. Në mbështetje të këtij arsyetimi, subjekti sjell në vëmendje nenin 31, pika 1 e ligjit nr. 84/2016, ku përcaktohet *se subjektet plotësojnë një deklaramë të re sipas shtojcës 2 bashkëlidhur këtij ligji*, si dhe nenin 32, pika 5 që parashikon *se deklaramet e interesave privatë dhe pasurorë, të paraqitur më parë pranë ILDKPKI-së, mund të përdoren si provë nga Komisioni dhe Kolegji i Apelimit.*

**10.2** Subjekti i rivlerësimit parashtron po ashtu se edhe çështja e ligjshmërisë së burimit të krijimit të pasurisë dhe përmbushja e detyrimeve lidhen me deklaramin në deklaramën *vetting* dhe jo me nëse pasuria e cila ka shërbyer si burim për krijimin e një pasurie tjetër, është deklaramuar në deklaramat e mëparshme periodike vjetore. Sipas subjektit të rivlerësimit, ky interpretim rrjedh nga neni 3, pika 19 e ligjit nr. 84/2016 që përcakton se të ardhurat e ligjshme do të konsiderohen të ardhurat sipas përcaktimeve të burimit të të ardhurave sipas ligjit “Për tatimin mbi të ardhurat”, i ndryshuar. Sipas kësaj dispozite, ligjshmëria e të ardhurave nuk lidhet me deklaramin apo jo në deklaramat e mëparshme periodike, por me nëse ajo është krijuar nga ndonjë prej burimeve që parashikon ligji mbi tatimin e të ardhurave.

Subjekti i rivlerësimit argumenton se kushtet që një burim të konsiderohet i ligjshëm janë dy: 1) subjekti i rivlerësimit të provojë se burimi është i ligjshëm; dhe 2) ky burim/e ardhura të jetë deklaramuar në deklaramën *vetting*. Nga kjo, vijon subjekti i rivlerësimit, rrjedh se, nëse provohet burimi dhe nëse ky burim është deklaramuar si i tillë në deklaramën *vetting*, pasuria nuk mund të konsiderohet rezultat i një burimi të paligjshëm, apo se jemi para deklarameve të pamjaftueshme apo deklaramave të pasakta.

**10.2.1** Trupi gjykues i Kolegjit konstaton se Komisioni ka konkluduar se subjekti i rivlerësimit ka mungesë të burimeve të ligjshme për të përballuar shpenzimet e për të krijuar kursimet në periudhën 2005-2016, situatë e cila e ka vendosur subjektin e rivlerësimit në kushtet e deklarameve të pamjaftueshme, për shkak të mungesës së burimeve financiare të ligjshme për të justifikuar pasuritë dhe shpenzimet e kryera, në përputhje me parashikimet e nenit D, pika 3 e Aneksit të Kushtetutës dhe nenit 61, pika 3 e ligjit nr. 84/2016. Pasuri, në kuptim të ligjit<sup>13</sup>, janë edhe likuiditetet, ligjshmërinë e burimit të të cilave subjekti i rivlerësimit ka pasur detyrimin të justifikonte.

**10.2.2** Nga analiza e procesit të rivlerësimit të kryer prej Komisionit, rezulton se përgjatë hetimit administrativ janë konsideruar/pranuar<sup>14</sup> shumë nga shpjegimet e pretendimet e subjektit të rivlerësimit. Disa nga konstatimet e kryera nga Komisioni janë kryekëput të bazuara në thëniet e

<sup>13</sup> Neni 3, pika 11 e ligjit nr. 84/2016, sipas të cilit “[...] 11. “Pasuri” janë të gjitha pasuritë e luajtshme dhe të paluajtshme në Republikën e Shqipërisë ose jashtë saj, sipas parashikimit të nenit 4, të ligjit nr. 9049, datë 10.4.2003, “Për deklaramin dhe kontrollin e pasurive, të detyrimeve financiare të të zgjedhurve dhe të disa nëpunësve publikë”, i ndryshuar që janë në pronësi, posedim ose në përdorim të subjektit të rivlerësimit [...]”, dhe neni 4 i ligjit nr. 9049/2003 thotë: “[...] Subjektet [...] detyrohen të deklarojnë në Inspektoratin e Lartë të Deklaramit dhe Kontrollit të Pasurive brenda datës 31 mars të çdo viti, gjendjen deri më 31 dhjetor të vitit paraardhës të pasurive, burimet e krijimit të tyre, si dhe të detyrimeve financiare si më poshtë: [...]d) vlerën e likuiditeteve, gjendje në çash, në llogari rrjedhëse, në depozitë, në bono thesari dhe në huadhënie, në lekë ose në valutë të huaj [...]”.

<sup>14</sup> Shih poshtëshënimin në faqen 19 të vendimit të Komisionit.

subjektit të rivlerësimit, ndërkohë që bien ndesh me dokumentacionin shkresor dhe detyrimet që përcakton ligji për organet e rivlerësimit në nenin 45, pika 2 dhe në nenin 49, pika 4 e ligjit nr. 84/2016 që përcaktojnë se:

“[2]. Gjatë hetimit administrativ, Komisioni, Kolegji i Apelimit dhe vëzhguesi ndërkombëtar mund të kërkojnë informacion [...]. Ata administrojnë *dokumentet* që vërtetojnë veprime, fakte, cilësi ose një situatë subjektive të nevojshme për realizimin e hetimit [...].”

“[...] Komisioni dhe Kolegji i Apelimit e bazojnë vendimin e tyre vetëm në dokumentet nga burime të njohura, në prova të besueshme ose që janë në pajtueshmëri të dukshme me provat e tjera. Ata kanë të drejtë të çmojnë, sipas bindjes së tyre të brendshme, çdo indicie në tërësi lidhur me rrethanat e çështjes [...].”

**10.2.3** Trupi gjykues i Kolegjit vëren se ndryshe nga sa pretendon subjekti, Komisioni ka pranuar, ndër të tjera, shpenzimet e subjektit lidhur me moskryerjen e shpenzimeve për mobilim. Ndër shpjegimet e pranuar nga Komisioni, një grup i tyre bien në kontradiktë me ligjin dhe me dokumentacionin. Komisioni ka pranuar shpjegimet e subjektit, të pambështetura në dokumentacion, sa i përket mospërputhjes dhe diferencës së çmimit të blerjes së apartamentit dhe garazhit të Komuna e Parisit në vitet 2000 dhe 2001 respektivisht, dhe burimit të krijimit të kursimeve të deklaruara prej tij, për të plotësuar shumën që mbetej për t’u paguar, përpos kredisë së marrë për këtë qëllim. Komisioni ka pranuar shpjegimet e subjektit, të cilat bien ndesh me dokumentacionin ligjor – kontratën dhe konfermat bankare – edhe sa u përket pasaktësive në lidhje me mënyrën e pagesës dhe çmimin e blerjes së zyrës prej 45 m<sup>2</sup> në Durrës në vitin 2005 – dhe mungesës së dokumentacionit provues të ndonjë forme për pagesën prej 10.000 eurosh, çka mund të përbënte indicie të një situate të mundshme fiktiviteti. Konkretisht, ndërsa sipas kontratës së datës 01.04.2005 palët pranojnë se janë likuiduar më parë plotësisht, pagesa ka kaluar te shitësi nëpërmjet bankës 18 ditë më pas, më 19.05.2005, ndërkohë që prona ishte regjistruar në emër të blerësit [subjektit të rivlerësimit dhe bashkëshortes] më 07.04.2005, 12 ditë përpara shlyerjes së vlerës së blerjes të *paplotë* (50.000 euro, 10.000 më pak sesa çmimi).

Më tej, Komisioni ka pranuar shpjegimet e subjektit, pa asnjë dokumentacion mbështetës dhe në kundërshtim të hapur me kushtet e kontratës, edhe për sa i përket mënyrës së përfitimit nga shitja e apartamentit në bashkëpronësi të bashkëshortes, deklaruar për herë të parë në deklaratën *vetting*, megjithëse ishte shitur më 10.12.2012 dhe nuk ishte deklaruar në asnjë nga gjashtë (6) deklaratat periodike vjetore që paraprinë deklaratën *vetting*, pavarësisht detyrimit ligjor të subjektit për ta kryer<sup>15</sup>. Megjithëse në kontratën e shitjes thuhet se çmimi është likuiduar *cash* në dorë, jashtë zyrës noteriale, përfitimi i të ardhurave është përlogaritur nga Komisioni sipas deklaramit në analizën financiare të sjellë nga subjekti për vitin 2012 dhe 2013 dhe sipas kronologjisë kohore të pretenduar prej tij, në dy pjesë: 700.000 lekë në vitin 2012 dhe 300.000 lekë në vitin 2013, pavarësisht nga përcaktimet e kushteve të kontratës apo mungesës së dokumentacionit që të provonte të kundërtën. Më tej, ndërsa konfermat bankare konfirmojnë se likuiditetet në fund të vitit 2004 ishin në vlerën 289.801 lekë, Komisioni e ka vendosur këtë vlerë në 420.000 lekë, siç pretendoi subjekti – pretendim që bie ndesh me vlerën e përlogaritur nga ekspertiza kontabël e paraqitur prej atij vetë, e cila i referohet vlerës së konfirmuar nga dokumentacioni. Më tej, Komisioni nuk është thelluar në hetimin e vlerave të dy apartamenteve prej 185 m<sup>2</sup> në Durrës, prej respektivisht 30 mijë eurosh dhe 4 milionë lekësh, blerë në vitet 2005 dhe 2017, ndërkohë që vetë Komisioni rezulton të ketë konstatuar se blerjet nuk përkonin as me çmimet e tregut dhe as me kostot e ndërtimit<sup>16</sup>.

<sup>15</sup> Sipas ligjit nr. 9049/2003, nenet 3/1 dhe 4.

<sup>16</sup> Shih faqet 8 dhe 11 të vendimit të Komisionit nr. 138, datë 09.04.2019.

**10.3** Në përmbledhje të sa më sipër, trupi gjykues i Kolegjit konstaton se konkluzioni i Komisionit se subjekti i rivlerësimit nuk ka arritur nivel të besueshëm në kontrollin e pasurisë, ka rrjedhur prej rezultateve të analizës financiare të kryer përgjatë procesit të rivlerësimit në Komision dhe jo si rezultat i pasaktësive të deklarimit në deklaratat periodike të pasurisë. Trupi gjykues i Kolegjit vëren se në pjesën arsyetuese të vendimit të Komisionit [nr. 138, datë 09.04.2019] janë referuar pasaktësi<sup>17</sup> të identifikuar në deklaratimet periodike të subjektit të rivlerësimit, të cilat nuk rezultojnë të kenë përbërë shkak për dhënien e masës disiplinore.

**10.3.i.** Në funksion të të qenit garantist dhe në dritën e parimit të mospërkeqësimit të pozitës së subjektit të rivlerësimit, këto pasaktësi të deklarimeve periodike, as trupi gjykues i Kolegjit nuk mund t'i konsiderojë si elemente që mund të përbëjnë shkak për aplikimin e masës disiplinore. Nisur nga ky qëndrim, trupi gjykues i Kolegjit konstaton se metodologjia e përdorur nga Komisioni për kryerjen e analizës financiare bazohet në të dhënat e deklaruara prej subjektit të rivlerësimit në deklaratën *vetting* për burimet që kanë shërbyer për krijimin e pasurisë, të cilat, me qëllim verifikimin e vërtetësisë e saktësisë së tyre, janë analizuar, përveç të tjerash, edhe në raport me të dhënat e deklaratave periodike të pasurisë të plotësuara nga subjekti i rivlerësimit, në kohën kur janë krijuar pasuritë, si dhe dokumentet shoqëruese të këtyre deklaratave të paraqitura nga subjekti i rivlerësimit ose personat e lidhur me të.

**10.3.ii.** Nga ana tjetër, trupi gjykues sjell në vëmendje që pretendimi i subjektit të rivlerësimit në paragrafin 10.2, se detyrimi për të provuar ligjshmërinë e burimit përmbushet edhe nëse nuk është deklaruar më parë, për sa kohë është deklaruar në deklaratën *vetting*, nuk qëndron. Këtë koncept Kolegji e ka shtjelluar në jurisprudencën e mëparshme, parë edhe në kontekstin e kohës. Konkretisht, sa i përket elementit të ligjshmërisë së burimit, në analizë të konceptit të deklarimit të pasurisë për funksionarët publikë dhe rregullimeve ligjore të tij, “[...] pasuria e pambuluar me burime të ligjshme në njërin nga deklaratat periodike vjetore, mbetet e tillë për gjithë periudhën deklaruese për një subjekt, deri në vitin 2016. Me fjalë të tjera, kalimi i viteve nuk ka asnjë efekt shues; pasuria e deklaruar pasaktësisht apo burimet e ligjshme të munguara mbeten në thelb me të njëjtat probleme si edhe në fillim. Nëse një subjekt blen pasuri në vitin 2011 apo 2012 me të ardhura të cilat nuk mbulohen nga burime të ligjshme që rrjedhin nga viti 2003 apo 2004, pasuritë mbeten të krijuara me burime të paligjshme, pavarësisht nga kalimi i kohës [...]”<sup>18</sup>. Mungesa e burimit të ligjshëm është element i qëndrueshëm.

**10.3.iii.** Në përfundim, lidhur me këtë shkak ankimi, në kushtet kur vendimi i Komisionit për dhënien e masës disiplinore të shkarkimit nga detyra për subjektin e rivlerësimit është marrë jo mbi bazën e pasaktësive në deklaratat periodike të pasurisë, por mbi bazën e rezultateve të analizës financiare, nga e cila ka rezultuar se subjekti i rivlerësimit gjendet në kushtet e pamjaftueshmërisë së burimeve të deklaruara në deklaratën *vetting* për krijimin e pasurisë dhe të kursimeve, trupi

<sup>17</sup> Në vendimin e Komisionit nr. 138, datë 09.04.2019, si pasaktësi në DVP janë evidentuar:

- Pasaktësi në DVP-në e vitit 2003 për deklarimin e vlerës totale të blerjes së apartamentit me sip. 124 m<sup>2</sup> në Tiranë, si dhe në lidhje me burimin e diferencës së çmimit përtej asaj të paguar me kredi (vendimi f. 5, paragrafi 1, pika III). Pas shpjegimeve të subjektit të rivlerësimit, Komisioni për këtë pasaktësi të evidentuar ka konkluduar se shpjegimet dhe provat e sjella nga SR kanë qenë bindëse.
- Komisioni ka gjetur gjithashtu si pasaktësi mosdeklarimin në DVP për vitin 2012 e vitin 2013 të të ardhurave të përfituara nga bashkëshortja e tij nga shitja e pjesës takuese të pasurisë që kishte në bashkëpronësi me familjen e saj të origjinës, e ardhur e cila në kushtet kur është deklaruar si burim nga SR në deklaratën *vetting*, është përfshirë si e ardhur e ligjshme në analizën ekonomike të kryer nga Komisioni (vendimi KPK, faqe 20, paragrafi 7.2, pika xxii dhe xxiv).

<sup>18</sup> Shih paragrafin 64.3: [http://kpa.al/wp-content/uploads/2020/07/Vendimi-A\\_Dollapaj-i-anonimizuar.pdf](http://kpa.al/wp-content/uploads/2020/07/Vendimi-A_Dollapaj-i-anonimizuar.pdf)

gjykues i Kolegjit e konsideron të pabazuar në fakte pretendimin e subjektit të rivlerësimit se pasaktësitë në deklaratimet periodike kanë dominuar mbi informacionin dhe deklarinimin e tij të deklaratës *vetting*, të plotësuar në kuadër të këtij procesi rivlerësimi.

C. *Shkaqet e ankimit që lidhen me vlerësimin e kriterit të pasurisë*

11. *Subjekti pretendon se vendimmarrja e Komisionit për kontrollin e pasurisë është rezultat i një analize të pasaktë, e cila ka ardhur si pasojë e vlerësimit të gabuar të provave të administruara nga Komisioni dhe mosmarrjes në konsideratë të të gjitha provave të sjella prej tij, pas kalimit të barrës së provës, pasi:*

- (i) *shpenzimet për jetesë dhe udhëtime janë përlllogaritur mjaft të larta në krahasim me ato që kanë qenë faktikisht, dhe nuk rezultojnë të njëjta me ato të aplikuara nga ILDKPKI-ja apo të dhënat e INSTAT-it, duke konsideruar ndër vite përbërjen familjare të subjektit të rivlerësimit;*
- (ii) *nuk janë përlllogaritur të plota të ardhurat nga puna e subjektit;*
- (iii) *nuk janë përlllogaritur për disa vite të ardhurat nga paga e bashkëshortes., si subjekt i vetëpunësuar, për të cilën janë paguar detyrimet tatimore;*
- (iv) *Komisioni nuk ka vlerësuar praktikën e sjella nga organet tatimore dhe konkluzionet shkencore të arritura nga akti i ekspertimit lidhur me të ardhurat nga aktiviteti noterial për periudhën 2008-2013.*

11.1 Në analizë të secilit prej pretendimeve të subjektit të rivlerësimit lidhur me mosvlerësimin e provave të sjella prej tij apo për vlerësim të gabuar të tyre, përpos konstatimeve më sipër në paragrafët 10.2 dhe 10.3, 10.3.ii - 10.3.iii, trupi gjykues i Kolegjit mori në analizë situatat të cilat subjekti i rivlerësimit referon këto mangësi, duke i parë ato në raport me analizën financiare të kryer nga Komisioni respektivisht në vitet 2005, 2007, 2008, 2010, 2013, 2014 dhe 2016, përgjatë të cilave subjekti i rivlerësimit ka rezultuar me diferencë negative për mbulimin e shpenzimeve me të ardhura të ligjshme. Për shqyrtimin e plotë të të gjitha këtyre pretendimeve të subjektit të rivlerësimit, trupi gjykues i Kolegjit kreu analizën financiare për secilin nga këto vite, të detajuar në pjesët vijuese të këtij vendimi. Ndërsa analiza e shkaqeve të ankimit të subjektit të rivlerësimit për analizën financiare të kryer për çdo vit nga Komisioni vetëm për vitet në të cilat ai ka rezultuar me situatë negative, vijon më pas, trupi gjykues i Kolegjit fillimisht trajtoi pretendimet e cituara në paragrafin 11 në tërësi.

11.2 *Në ankim në tërësi për analizën financiare të kryer nga Komisioni, subjekti pretendon se shpenzimet e jetesës për të gjithë periudhën e rivlerësimit janë konsideruar me vlera më të mëdha sesa ato kanë qenë faktikisht, duke rritur në mënyrë artificiale shpenzimet e tij, të cilat gjithashtu rezultojnë edhe më të larta edhe nga përlllogaritja e ILDKPKI-së, mbi bazën e numrit të personave të familjes.*

11.3 Referuar analizës financiare të kryer nga Komisioni, përfshirë në vendimin nr. 138, datë 09.04.2019, për periudhën 2003-2016<sup>19</sup>, si dhe në rezultatet paraprake të hetimit të përcjella subjektit të rivlerësimit, vërehet se në zërin “shpenzime” janë përlllogaritur së bashku kostot e jetesës, shpenzimet e udhëtimit dhe çdo shpenzim tjetër i kryer nga subjekti i rivlerësimit, si për shembull pagesa e kësteve të kredive apo shpenzime shkollimi. Pasi konstatoi se në aktet e administruara në fashikull mungonin të dhënat mbi metodologjinë e kryerjes së saj, në funksion të

<sup>19</sup> Tabela në faqen 17 të vendimit nr. 138, datë 09.04.2019, të Komisionit të Pavarur të Kualifikimit.

dhënies përgjigje të shkaqeve të ankimit, trupi gjykues i Kolegjit mori informacion shtesë<sup>20</sup> nga Komisioni.

**11.4** Për një shqyrtim të plotë të pretendimit të subjektit të rivlerësimit lidhur me kostot e jetesës, Kolegji kreu një përlllogaritje duke u bazuar në vlerat e sjella/konfirmuara nga korrespondenca e Kolegjit me ILDKPKI-në<sup>21</sup>, të cilat janë përdorur nga Kolegji për përlllogaritjen e shpenzimeve të jetesës edhe për subjektet e tjera të rivlerësimit, pas marrjes së këtij informacioni. Shpenzimet e jetesës të përlllogaritura nga Kolegji për periudhën 2003-2016 ndryshojnë nga vlerat e identifikuar vit pas viti si kosto jetese nga Komisioni. Këto shpenzime, në analizën financiare të Kolegjit për gjithë periudhën 2003-2016, rezultojnë të jenë në vlerën 7.737.406<sup>22</sup> lekë, e cila është më e vogël se vlera e identifikuar nga analiza e detajuar e Komisionit për këtë periudhë. Në trajtimin e detajuar në vijim të shkaqeve të ankimit mbi analizën e secilit vit, janë përfshirë vlerat e përlllogaritura sipas analizës së Kolegjit.

**11.5** *Me të njëjtin arsytim – për pamundësi të identifikimit të vlerës së kostove të shpenzimeve të udhëtimit – subjekti i rivlerësimit kundërshton analizën e Komisionit, pasi kostot për udhëtime janë përlllogaritur nga Komisioni më të larta sesa kanë qenë realisht.* Lidhur me këtë element të pretendimeve të subjektit, trupi gjykues i Kolegjit konstaton, së pari, se shpenzimet për udhëtim janë bazuar në të dhënat e sistemit TIMS. Subjektit të rivlerësimit i ka kaluar barra e provës nga Komisioni [me rezultatet paraprake të hetimit] dhe ka paraqitur si provë për to vetëm një deklaratë noteriale<sup>23</sup>, për mbulimin pjesërisht të shpenzimeve të qëndrimit në udhëtimin e vitit 2009 dhe 2010 në Itali, dhe një praktikë të një udhëtimit për arsye pune<sup>24</sup>.

**11.5.1.** Siç është shtjelluar edhe më sipër në paragrafin 11.3, në analizën e Komisionit në vendim<sup>25</sup>, shpenzimet e udhëtimit nuk janë identifikuar në mënyrë specifike, por janë përfshirë si shpenzime të vitit korrent së bashku me kostot e jetesës. Së dyti, pas vënies në dispozicion të analizës së detajuar, trupi gjykues i Kolegjit konstaton se Komisioni ka kryer përlllogaritje të shpenzimeve të udhëtimit duke u bazuar në të dhënat e marra nga sistemi TIMS, të vëna në dispozicion nga Policia e Shtetit për periudhën 2008-2016. Së treti, referuar të dhënave mbi evidentimin e udhëtimeve të subjektit të rivlerësimit, nga aktet e administruara nga Komisioni nga sistemi TIMS për hyrje-daljet e tij, nuk rezultojnë të dhëna për lëvizjet e subjektit të rivlerësimit dhe të familjarëve për periudhën 2004-2007, periudhë për të cilën Komisioni ka përlllogaritur shpenzime udhëtimit jashtë vendit.

<sup>20</sup> Analiza financiare e detajuar i është kërkuar Komisionit nga gjyqtarja relatores e Kolegjit nëpërmjet komunikimit elektronik të datës 11.05.2020 dhe prej Komisionit i është përcjellë Kolegjit nëpërmjet komunikimit elektronik të datës 13.05.2020.

<sup>21</sup> Të dhëna të sjella në Kolegj nga ILDKPKI-ja me shkresën nr. {\*\*\*} prot., datë 04.03.2019, protokolluar në Kolegj me nr. {\*\*\*} prot., datë 04.03.2019.

<sup>22</sup> Nga ana e Kolegjit përlllogaritja e kësaj vlere që u korrespondon kostove të jetesës, është bërë duke iu referuar të dhënave bazë për konsumin vjetor për frymë dhe numrin e personave të njësisë familjare, marrë nga INSTAT, përkatësisht: për vitin 2003 nga anketa e matjes së nivelit të jetesës (LSMS 2002); për vitin 2004 nga anketa e matjes së nivelit të jetesës (LSMS 2002); për vitin 2005 nga anketa e matjes së nivelit të jetesës (LSMS 2005); për vitin 2006 nga anketa e matjes së nivelit të jetesës (LSMS 2005); për vitin 2007 nga anketa e buxhetit të familjes (ABF 2006-2007); për periudhën 2008- 2011 nga anketa e matjes së nivelit të jetesës (LSMS 2008); për periudhën 2012- 2013 nga anketa e matjes së nivelit të jetesës (AMNJ 2012); për vitin 2014-2016 nga anketa e buxhetit të familjes (ABF 2014/2015/2016).

<sup>23</sup> Deklaratë noteriale me nr. {\*\*\*} rep., e nr. {\*\*\*} kol., e datës 19.03.2019, e lëshuar nga z. E. P. e A. P., të afërm të subjektit të rivlerësimit (djali i tezes), deklarojnë se subjekti i rivlerësimit dhe bashkëshortja e tij në vitin 2009 dhe në vitin 2010 kanë qëndruar në banesën e tyre në Itali, pa asnjë shpenzim.

<sup>24</sup> Urdhër i Prokurorisë së Përgjithshme nr. {\*\*\*} prot., datë 17.03.2014, për pagesën e shpenzimeve të pjesëmarrësve në Konferencën e Vjenës e Zagrebit të Konferencës së 14-të rajonale të Shoqatës Ndërkombëtare të Prokurorëve.

<sup>25</sup> Tabela në faqen 17 të vendimit nr. 138, datë 09.04.2019, të Komisionit të Pavarur të Kualifikimit.

**11.5.2** Pasi konstatoi se në fashikullin e krijuar përgjatë hetimit nga Komisioni nuk rezultojnë të dhëna nga sistemi TIMS për lëvizjet e subjektit të rivlerësimit dhe të familjarëve për periudhën 2004-2007, megjithëse janë përlllogaritur shpenzime udhëtimit, trupi gjykues i Kolegjit kreu aksesimin në sistemin TIMS për marrje të të dhënave për hyrje-daljet e subjektit të rivlerësimit dhe të familjarëve për këtë periudhë, bazuar në përcaktimet e nenit 50, pika 2, germa “ç”<sup>26</sup> e ligjit nr. 84/2016. Përlllogaritja e shpenzimeve të udhëtimit, si rrjedhojë, u bazua në këto të dhëna dhe sipas metodologjisë<sup>27</sup> së aplikuar nga Kolegji në të gjitha rastet kur shpenzimet e udhëtimit kanë qenë pjesë e analizës financiare. Po ashtu, në kushtet ku subjekti i rivlerësimit për shpenzimet për udhëtim nuk ka paraqitur prova lidhur me mbulimin e këtyre kostove nga persona të tretë, trupi gjykues i Kolegjit për të qenë garantist, çmoi që në analizën financiare, për vitet 2004-2007, vlerat<sup>28</sup> e përfshira në analizë nga Komisioni të lihen të pandryshuara për shpenzimet e udhëtimit.

**11.5.3.** Për periudhën 2008-2016, për të cilën nga Komisioni rezultonin të administruara të dhëna nga sistemi TIMS për hyrje-daljet e subjektit të rivlerësimit dhe të familjarëve, në funksion të shkaqeve të ankimit, trupi gjykues i Kolegjit, bazuar në metodologjinë<sup>29</sup> e aplikuar për llogaritjen e shpenzimeve për udhëtimet, kreu një përlllogaritje të shpenzimeve të udhëtimit, të cilat më pas u reflektuan në analizën financiare të çdo viti, gjatë të cilit subjekti i rivlerësimit ka rezultuar me pamundësi financiare për të mbuluar shpenzimet me të ardhura të ligjshme, të detajuar në paragrafët vijues të këtij vendimi, e të cilët kanë qenë objekti i shkaqeve të ankimit në këtë çështje.

**11.6.** *Subjekti i rivlerësimit parashtron se në analizën financiare të kryer nga Komisioni, nuk janë llogaritur të plota të ardhurat nga paga e subjektit të rivlerësimit, të cilat, sipas dokumentacionit bankar të dorëzuar nga subjekti në cilësinë e provës, për disa vite rezultonin më të larta se ato të pasqyruara nga vërtetimet e lëshuara nga zyra ekonomike e Prokurorisë.* Subjekti gjithashtu pretendon se në vërtetimet mbi të ardhurat nga puna, të lëshuara nga Prokuroria e Rrethit Gjyqësor Durrës, nuk janë përfshirë të ardhurat nga orët jashtë orarit, shpërblimet dhe kompensimet e përfituara prej tij, si drejtues, për shpenzimet e transportit.

**11.6.1.** Në analizë të këtij shkakut ankimi, trupi gjykues i Kolegjit konstaton se analiza e Komisionit për të ardhurat e subjektit të rivlerësimit nga puna për vitin 2005, në vlerën 1.297.681 lekë, bazohet në të dhënat e marra nga dy vërtetime të lëshuara respektivisht nga Prokuroria e Apelit Tiranë dhe Prokuroria Apelit Durrës<sup>30</sup>. Pjesë e akteve të administruara nga Komisioni, nga korrespondenca me bankat e nivelit të dytë, janë edhe dy vërtetime<sup>31</sup>, përkatësisht nga *Raiffeisen Bank* dhe *Intesa Sanpaolo*. Referuar këtyre të dhënave të llogarive bankare, trupi gjykues i Kolegjit konstaton se

---

<sup>26</sup> Neni 50, “Aksesi në informacion”, pika 2, germa “ç” e ligjit nr. 84/2016 parashikon:

“[...] 2. Komisioni, Kolegji i Apelit dhe vëzhguesit ndërkombëtarë kanë akses të plotë në të gjitha të dhënat, pranë Prokurorisë së Posaçme, sipas nenit 148, pika 4, të Kushtetutës, si dhe në të dhënat që vijnë: [ç] në [...] bazat e të dhënave mbi automjetet, të dhënat për hyrje-daljet në kufi [...]”.

<sup>27</sup> Për metodologjinë e përlllogaritjes së shpenzimeve në udhëtim, shih vendim e Kolegjit të Posaçëm të Apelit nr. 11/2019 (JR), datë 22.05.2019.

<sup>28</sup> Komisioni ka përlllogaritur për shpenzimet e udhëtimit për vitet 2004-2007 vlerat si vijojnë: për vitin 2004 në vlerën 270.590 lekë, për vitin 2005 në vlerën 240.178 lekë; për vitin 2006 në vlerën 321.967 lekë; për vitin 2007 në vlerën 150.000 lekë.

<sup>29</sup> Shih më sipër poshtëshënimin nr. 27.

<sup>30</sup> Vërtetimi i lëshuar nga Prokuroria e Apelit Tiranës, nr. extra prot., datë 11.10.2016, sipas të cilit të ardhurat nga paga për vitin 2005, për subjektin e rivlerësimit, janë në vlerën 735.168 lekë dhe vërtetimi i lëshuar nga Prokuroria e Apelit Durrës, datë 18.10.2016, për të ardhurat nga orët jashtë orarit, për vitin 2005, në vlerën 562.513 lekë.

<sup>31</sup> Statement-i i Bankës Raiffeisen, si dhe vërtetimi i lëshuar nga Banka Raiffeisen nr. {\*\*\*}, datë 18.03.2019, që u korrespondon pagesave të bëra nga Prokuroria e Apelit të Tiranës në vlerën 847.873 dhe Statement-i i Bankës “Intesa Sanpaolo” prot. nr. {\*\*\*}, datë 12.02.2018, që u korrespondon pagesave nga Prokuroria e Apelit Durrës, në vlerën 558.567 lekë.



totali i vlerës së përfituar nga subjekti i rivlerësimit, me burim nga paga dhe orët jashtë orarit, për vitin 2005 është në vlerën 1406440 lekë. Në funksion të kësaj situatë faktike, trupi gjykues i Kolegjit vlerësoi të korrigojë në analizën ekonomike të vitit 2005 vlerën e evidentuar në konfermat bankare në shumën prej 1406440 lekësh, e cila e përmirëson analizën ekonomike të vitit 2005 me (+) 108759 lekë.

**11.6.2.** Në vijim, subjekti i rivlerësimit pretendon që për vitin 2013, të ardhurat e tij nga puna të përfshira në analizën e Komisionit, duhet të ndryshojnë, duke përfshirë në to edhe pagesat për transportin që ka përfituar në cilësinë e drejtuesit të prokurorisë<sup>32</sup>. Në analizë të këtij pretendimi të subjektit të rivlerësimit, në kuptim të analizës ekonomike, Kolegji konstaton se në secilin version, marrja ose jo në konsideratë e kësaj shume nuk ndryshon në tërësi analizën financiare të kryer në Komision për periudhën kur është marrë kjo pagesë. Nga ana tjetër, Kolegji konstaton se pagesa e bonusit të karburantit nga punëdhënësi, Prokuroria e Apelit Durrës, është bërë për të mbuluar një shpenzim të konsideruar të kryer nga subjekti dhe, si i tillë, destinuar në funksion të ushtrimit të detyrës, për mbulimin e kostove të transportit të lidhura me ushtrimin e saj. Në këtë këndvështrim, kërkesa e subjektit për përfshirjen e një vlere alokuar atij në funksion zyrtar dhe për përdorim zyrtar, si e ardhur personale, është alogjike. Këto rimbursime për shpenzime zyrtare, nëse nuk janë nevojitur/përdorur, nuk duhet të përfitoheshin. Pretendimi i subjektit do të vlente vetëm në qoftë se në shpenzimet e jetesës do të ishin përlllogaritur shpenzime udhëtimi në funksion zyrtar, gjë që nuk është rasti. Për rrjedhojë, ky pretendim i subjektit është pa ndikim në analizë, përveçse i pabazuar në ligj.

**11.7** Subjekti i rivlerësimit parashtrohet se në analizën financiare të kryer nga Komisioni, nuk janë përlllogaritur të ardhurat e bashkëshortes së subjektit të rivlerësimit nga paga si notere, për të cilat janë paguar detyrimet tatimore. Sipas subjektit të rivlerësimit, pagat janë përlllogaritur si shpenzime në pasqyrat financiare të aktivitetit privat të bashkëshortes se tij (si person fizik). Trupi gjykues i Kolegjit vëren se ky pretendim i referohet analizës së Komisionit për vitet 2008, 2009, 2010 gjatë të cilëve subjekti i rivlerësimit shprehet se të ardhurat e bashkëshortes nga paga kanë qenë respektivisht në vlerat 151668 lekë, 156244 lekë dhe 146000 lekë.

**11.7.1** Në analizë të këtij pretendimi, nga dokumentet financiare të administruara nga hetimi administrativ lidhur me aktivitetin e personit të lidhur si person fizik (notere), trupi gjykues i Kolegjit vëren se në pasqyrat financiare të rivlerësuar<sup>33</sup>, rezultojnë që tatimpaguesja për këto vite, në pasqyrat financiare ka paraqitur si “shpenzim” pagën e personit fizik. Për vitet 2008, 2009 dhe 2010, paga e deklaruar përkon me vlerat e parashtuara nga subjekti i rivlerësimit dhe pasqyruar më sipër në paragrafin 11.7. Bazuar në këto të dhëna, duke qenë se paga është deklaruar si “shpenzim për njësinë ekonomike” (personin fizik), që tregon se kjo vlerë nuk ka përbërë pjesë të fitimit të vitit ushtrimor, por është paguar *pagë për individin* dhe për të cilën gjithashtu rezultojnë se janë paguar edhe detyrimet e sigurimeve shoqërore e shëndetësore, trupi gjykues i Kolegjit vlerëson se këto vlera duhet të përfshihen te të ardhurat e bashkëshortes së subjektit të rivlerësimit për vitet respektive kur janë krijuar.

---

<sup>32</sup> Në pyetësorin nr. 4, subjekti i rivlerësimit i ka pretenduar se gjatë vitit 2013 ka përfituar “bonus” prej 35.000 lekësh çdo muaj, shumë të cilën e përfitonin drejtuesit e prokurorisë. Nga ana tjetër, nga konferma bankare e lëshuar nga Raiffeisen Bank, në shumën prej 35.000 lekësh, e kredituar çdo muaj nga Prokuroria e Apelit të Durrësit [totali për vitin 2013 në vlerën 245.000 lekë] rezultojnë me përshkrimin “Transport - Ferdinand Elezi”.

<sup>33</sup> Mbi të cilat janë konfirmuar dhe fitimet e këtyre viteve të njohura nga Komisioni, duke u mbështetur në shkresën nr. {\*\*\*}, datë 25.01.2019, të Drejtorisë Rajonale Tatimore Durrës.

**11.8** Subjekti pretendon po ashtu se të ardhurat e aktivitetit noterial të bashkëshortes për periudhën 2008-2013 janë konsideruar në vlera më të vogla sesa ato reale, ndërkohë që për këto vite tatimi është paguar me vonesë, për shkak të rivlerësimit nga organet tatimore, si dhe përcaktimeve ligjore mbi modalitetet e pagimit të tatimeve pas mbylljes dhe deklarimit të pasqyrave financiare për vitin ushtrimor. Për këtë shkak ankimi, subjekti i rivlerësimit ka pretenduar se Komisioni nuk ka vlerësuar/konsideruar konkluzionet *shkencore* të arritura nga akti i ekspertimit, lidhur me të ardhurat nga aktiviteti noterial për periudhën 2008-2013.

**11.8.1.** Në analizë të akteve shkresore lidhur me këtë shkak ankimi, Kolegji konstaton se për përlllogaritjen e të ardhurave nga aktiviteti noterial i bashkëshortes së subjektit të rivlerësimit, Komisioni është mbështetur në shifrat e pasqyruara në shkresën zyrtare të Drejtorisë Rajonale Tatimore Durrës<sup>34</sup> (në vijim “DRT Durrës”). Nga aktet e administruara në fashikull përgjatë hetimit administrativ, vërehet se Komisioni i ka kaluar subjektit të rivlerësimit barrën e provës me rezultatet e hetimit paraprak<sup>35</sup> në kuadër të analizës ekonomike të kryer për periudhën 2003-2016, për të provuar burimet e ligjshme për të mbuluar shpenzimet e për të krijuar pasuritë e tij. Subjekti i rivlerësimit ka shpjeguar situatën e tij financiare, si dhe i ka përcjellë Komisionit në cilësinë e provës akt-ekspertimin e ekspertit, z. B. B.<sup>36</sup>. Me anë të këtij akt-ekspertimi, subjekti i rivlerësimit pretendon se përlllogaritja e pagesës së detyrimeve tatimore nga Komisioni, për aktivitetin e bashkëshortes si “person fizik”, duhej kryer duke iu referuar kohës së realizimit faktik të këtyre pagesave, pasi vetëm në këtë mënyrë mund të identifikohet fitimi real i personit fizik ndër vite.

**11.8.2.** Në analizë të shkresës zyrtare të DRT Durrës<sup>37</sup>, trupi gjykues i Kolegjit vëren se në të, ashtu si dhe në praktikën bashkëlidhur saj, jepen të dhëna financiare për të gjithë aktivitetin si “person fizik” të personit të lidhur (bashkëshortes së subjektit të rivlerësimit) që kanë të bëjnë me qarkullimin financiar, fitimin para taksave, tatimin për t’u paguar, parapagimet në bashki, si dhe tatimin e paguar në DRT Durrës, për vitet 2000-2017. Nga analiza e shifrave të vendosura nga Komisioni në analizën ekonomike të vendimit për të ardhurat nga aktiviteti i bashkëshortes së subjektit të rivlerësimit, Kolegji konstatoi se Komisioni ka identifikuar të ardhurat nga aktiviteti i bashkëshortes si “person fizik”, duke zbritur nga vlera e dhënë në shkresë si “Fitimi para taksave” vlerën e identifikuar si “Tatimi i paguar në DRT Durrës”, pa zbritur parapagimin në Zyrën e Taksave në Bashkinë Durrës, i cili është një detyrim i kryer përgjatë vitit ushtrimor. Në faqen 17 të vendimit të tij, Komisioni pasqyron analizën e tij financiare për këtë aspekt.

**11.8.3.** Referuar akteve të administruara në Komision, Kolegji konstaton se subjekti i rivlerësimit, në funksion të përlllogaritjes së fitimit të bashkëshortes së tij, ka paraqitur shpjegime mbi rezultatet paraprake të hetimit, si dhe dokumentacion mbështetës për to. Nga shqyrtimi i akteve të përcjella Komisionit nga subjekti i rivlerësimit, Kolegji konstaton se pjesë e tyre është shkresa tjetër e DRT Durrës [me nr. {\*\*\*}], datë 15.03.2019, e cila pasqyron vlerësimin e të ardhurave dhe shpenzimeve të subjektit tatimor B. P. [bashkëshortja e subjektit të rivlerësimit] si “person fizik” për periudhën 2008-2012.

**11.8.4.** Në analizë të kësaj situate, për të identifikuar fitimin e realizuar prej aktivitetit privat të bashkëshortes së subjektit të rivlerësimit, trupi gjykues i Kolegjit i vlerësoi konkluzionet e

---

<sup>34</sup> *Shih faqen 17 të vendimit të Komisionit, poshtëshënimin 12 ku Komisioni i referohet shkresës së Drejtorisë Rajonale të Tatimeve Durrës me nr. {\*\*\*} prot., datë 25.01.2019, dhe praktikës bashkëlidhur kësaj shkrese, të administruar nga Komisioni.*

<sup>35</sup> *Vënë në dispozicion subjektit të rivlerësimit nga Komisioni më datë 07.03.2019.*

<sup>36</sup> *Subjekti i rivlerësimit i ka paraqitur Komisionit, më datë 21.03.2018, shpjegimet e tij të shoqëruara me dokumentacion mbështetës, pjese e të cilit ka qenë edhe akt-ekspertimi i z. B. B..*

<sup>37</sup> *Shih poshtëshënimin 34 më sipër.*

Komisionit në konsideratë të shkaqeve të ankimit dhe akteve të administruara përgjatë hetimit. Nga ky shqyrtim, rezulton se ndryshe nga sa është përcaktuar *shprehimisht* në dispozitat e legjislacionit tatimor<sup>38</sup>, rivlerësimi i aktivitetit të bashkëshortes së subjektit të rivlerësimit nuk është kryer kryesisht, *a proprio motu*, nga administrata tatimore, por si pasojë e kërkesës *së përsëritur* të vetë tatimpagueses. Së fundmi, nga praktika e rivlerësimit e kryer nga DRT Durrës, rezulton se subjektet tatimore (personat fizikë) paguajnë tatime në formën e parapagimeve gjatë/brenda vitit ushtrimor. Diferenca, në varësi të volumit të të ardhurave, saktësohet dhe paguhet si detyrim pasi subjekti tatimor paraqet dhe depoziton pasqyrat financiare të vitit ushtrimor – brenda 3 muajve të parë të vitit pasardhës (deri më 31 mars). Sipas legjislacionit tatimor në fuqi, në momentin e dorëzimit të pasqyrave financiare, bëhet edhe deklarimi i të ardhurave dhe i fitimit të vitit ushtrimor dhe subjekti në këtë moment paguan tatim-fitimin e vitit.

**11.8.5.** Subjekti i rivlerësimit ka pretenduar se si vlera të fitimit të aktivitetit të bashkëshortes duhet të konsideroheshin të ardhurat e realizuara në vitin korrent duke zbritur vetëm parapagimet që realisht janë shpenzim i kryer atë vit. Diferenca e detyrimeve, të cilat janë saktësuar në vitin pasardhës, duhet të përlllogaritet si shpenzim në vitin pasardhës. Në këtë mënyrë, subjekti i rivlerësimit pretendon shpenzimet mbi pagesën e tatimeve duhen shpërndarë dhe llogaritur sipas kohës kur kanë ndodhur. Meqenëse rezulton se vetëm parapagimi i tatimit është shlyer gjatë vitit ushtrimor, ndërsa pjesa tjetër e tatimit është paguar gjatë viteve pasardhëse, trupi gjykues i Kolegjit vendosi ta pranojë këtë pretendim të subjektit të rivlerësimit pjesërisht, duke zhvendosur diferencën e mbetur dhe paguar në kohën përkatëse, si pasojë e pasqyrave financiare të depozituara brenda 31 marsit të çdo viti pasardhës. Konkretisht, në analizën financiare në Kolegj, trupi gjykues e ka përlllogaritur pagesën e diferencës së tatimit pas parapagimit në vitin 2008, të paguar deri më 31 mars 2009, e kështu me radhë, pagesën për diferencën e vitit 2009, të paguar deri më 31 mars 2010, pagesën për diferencën e vitit 2011, të paguar deri më 31 mars 2012 – siç parashtron shkresa e DRT Durrës e që duhet të ketë ndodhur përpara rivlerësimit.

**11.8.6.** Nga ana tjetër, Komisioni rezulton të ketë ndjekur një arsyetim kontradiktor në vetvete. Në dritën e logjikës së ndjekur nga Komisioni, i cili i ka pranuar pa reflektuar dinamikën e rivlerësimit të aktivitetit noterial të bashkëshortes së subjektit, shpenzimet e dokumentuara nëpërmjet transfertës bankare<sup>39</sup> për të plotësuar tatimet e rivlerësuara, do të duhet të ishin pranuar të paguara në vlerën e paguar në vitin 2017, ndërsa shpenzimet për tatimet ndër vite, përfshirë edhe vitet në analizë [2009-2011], sipas vlerës së përlllogaritur nga administrata tatimore në momentin kur janë paguar realisht [përpara rivlerësimit] dhe sipas gjendjes së aktivitetit të deklaruar nga personi fizik në momentin e deklarimit. Dinamika e procedurës së ndjekur për rivlerësimin e një subjekti tatimpagues – personit të lidhur të subjektit të rivlerësimit me aktivitet notere – sipas të cilit vetë tatimpaguesi kërkon

---

<sup>38</sup> Ligji nr. 9920, datë 19.05.2008, “Për procedurat tatimore në Republikën e Shqipërisë”, neni 68 dhe neni 73 përcaktojnë:

Neni 68: “1. Vlerësimi tatimor: a) është llogaritja e detyrimit tatimor të tatimpaguesit nga administrata tatimore; [...] 4. Nëse administrata tatimore konstaton se detyrimi tatimor, i dhënë në deklaratën tatimore, është i pasaktë ose tatimpaguesi nuk ka dorëzuar deklaratë tatimore apo nuk ka paguar detyrimin tatimor, administrata tatimore bën vlerësimin tatimor. (Ndryshuar me ligjin nr. 112/2016, datë 03.11.2016. Botuar në Fletoren Zyrtare nr. 219, datë 15 nëntor 2016).

Neni 73, lidhur me të drejtën e administratës tatimore për të bërë vlerësim tatimor, si dhe të drejtën e tatimpaguesit për të kërkuar tepricën kreditore përcakton: “[...] 1. E drejta e administratës tatimore për të bërë një vlerësim tatimor parashkruhet brenda 5 vjetëve nga data e fundit e dorëzimit të deklaratës tatimore, fillestare ose të ndryshuar, të përcaktuar në legjislacionin tatimor përkatës [...]”. (Ndryshuar me ligjin nr. 112/2016, datë 03.11.2016. Botuar në Fletoren Zyrtare nr. 219, datë 15 nëntor 2016).

<sup>39</sup> Të paguara nëpërmjet transaksioneve të kryera pranë Bankës Credins më datë 23.12.2017.

rivlerësim, rezulton të jetë e paparashikuar në ligjin që rregullon procedurat tatimore (shih edhe poshtëshënimin 37 dhe paragrafin 11.8.4). Sipas logjikës që deduktohet nga norma ligjore [neni 73 i ligjit nr. 9920/2008], ligji parashikon vetëm rrethana të së drejtës për kreditim nga subjektet tatimpaguese. Ky element nuk është hetuar nga Komisioni në asnjë hap të procesit të hetimit administrativ. Po ashtu, Komisioni duhet të kishte shpjeguar përse ka vendosur të përllogaritë shpenzimet për pagesën e tatimit të rivlerësuar në 2017 në vitet 2009-2011 në mënyrë retroaktive. Së fundmi, Komisioni nuk rezulton të ketë hetuar apo të jetë shprehur e pyetur subjektin e rivlerësimit në lidhje me momentin dhe dinamikën se si përfitimet nga aktiviteti i bashkëshortes janë përdorur për nevoja familjare, në dritën e nenit 27<sup>40</sup> të ligjit “Për noterinë”, që ka qenë në fuqi deri në dhjetor 2018, sipas të cilit të ardhurat nga aktiviteti i përkasin noterit vetëm *pasi kryhet pagesa e detyrimeve financiare*. Trupi gjykues i Kolegjit çmon t’i vëre në dukje këto mangësi si tërheqje vëmendjeje për Komisionin, së bashku me konstatimin e shtjelluar në hollësi më sipër, sa i përket pranimit të deklarimeve të subjektit që bien ndesh me dokumentacionin, sjellë në vëmendje në paragrafin 10.2.3, ndërsa në zbatim të parimeve të gjykimit në shkallë të dytë [mospërkeqësimin e pozitës së ankuesit], nuk i shoqëron këto konstatime me pasoja për subjektin e rivlerësimit.

**11.8.7.** Në përmbledhje të akteve<sup>41</sup> të marra në konsideratë për përllogaritjen e fitimit nga aktiviteti privat i bashkëshortes së subjektit të rivlerësimit, trupi gjykues i Kolegjit vëren se të dhënat që këto shkresa japin për aktivitetin e bashkëshortes për periudhën 2007-2013, saktësojnë momentin e shlyerjes së detyrimeve në vitin vijues, pas mbylljes dhe deklarimit të pasqyrave financiare, si dhe evidentojnë vlerat e detyrimit për t’u paguar nga subjekti tatimor pas vlerësimit nga organet tatimore në vitin 2017. Nga analiza e kryer në Kolegji, sa i përket fitimit nga aktiviteti i bashkëshortes së subjektit të rivlerësimit si “person fizik” për vitet 2007-2013, referuar detyrimeve për të cilat ka konfirmim për kohën kur janë paguar, ato janë zhvendosur si detyrime të paguara në vitin respektiv<sup>42</sup>. Në analizën financiare në vijim, pasqyrohen vlerat e përllogaritura sipas shkresave të DRT Durrës dhe rivlerësimit të kërkuar nga tatimpaguesja, pranuar dhe në linjë me arsyetimin e Komisionit, reflektuar në analizën financiare të çdo viti në të cilin subjekti i rivlerësimit ka rezultuar me mungesë të burimeve të ligjshme për mbulimin e shpenzimeve dhe krijimin e kursimeve të periudhës 2003-2016.

- 12 Sipas analizës financiare të vendimit të Komisionit për vitin 2005, subjekti i rivlerësimit rezulton me mungesë të burimeve të ligjshme në masën prej 551419 lekësh. Për këtë rezultat të analizës financiare të Komisionit, subjekti i rivlerësimit në ankim ka paraqitur kundërshtitë e tij duke pretenduar se:

*[...] Analiza e Komisionit për vitin 2005, (i) nuk është e saktë në drejtim të llogaritjes së të ardhurave të përfituara nga puna e tij dhe përfitime të tjera të bashkëshortes; (ii) ka*

<sup>40</sup> Neni 27, fjalia e dytë parashikon: “[...] Të ardhurat që burojnë nga veprimtaria noteriale e noterit, pasi paguhen taksat dhe detyrimet e tjera që parashikon ligji, kalojnë në pronësi të noterit”.

<sup>41</sup> Shkresa e DRT Durrës nr. {\*\*\*} prot., datë 25.01.2019, që përmban të dhëna financiare për të gjithë aktivitetin si “person fizik” të personit të lidhur (bashkëshortes së subjektit të rivlerësimit), që kanë të bëjnë me qarkullimin financiar, fitimin para taksave, tatimin për t’u paguar, parapagimet në bashki, si dhe tatimin e paguar në Drejtorinë Rajonale Tatimore Durrës dhe shkresa e dytë e DRT Durrës me nr. {\*\*\*}, datë 15.03.2019, e cila shprehet mbi vlerësimin e të ardhurave për periudhën 2008-2012, bashkëlidhur së cilës ndodhen të gjitha transaksionet për shlyerjen e detyrimeve në vitin 2017.

<sup>42</sup> Viti 2008, me fitim në vlerën 3.018.194 lekë dhe detyrime tatimore në vlerën 22.000 lekë; viti 2009, me fitim në vlerën 2.815.113 lekë dhe detyrime tatimore në vlerën 18.527 lekë; viti 2010, me fitim në vlerën 1.486.697 lekë dhe detyrime tatimore në vlerën 5.000 lekë; viti 2011, me fitim në vlerën 1.638.113 lekë; viti 2012, me fitim në vlerën 1.516.484 lekë dhe detyrime tatimore në vlerën 32.450 lekë; viti 2013 me fitim në vlerën 2.240.417 lekë dhe detyrime tatimore në vlerën 92.248 lekë.

*pasaktësi në përlllogaritjen e shpenzimeve të udhëtimit dhe ato të jetesës; (iii) në të nuk është përfshirë gjendja cash e likuiditeteve të kursyera nga viti paraardhës (2004); (iv) si dhe është e pasaktë gjendja e likuiditeteve në llogarinë bankare pranë Bankës Intesa San Paolo [...]”.*

**12.1** Për sa u përket pretendimeve të subjektit të rivlerësimit mbi vlerën e të ardhurave të përfituara prej tij nga paga për vitin 2005, siç është parashtruar edhe në paragrafët më sipër, ai kërkon përfshirjen në analizë të vlerave të përfituara sipas evidentimit të *statement-eve* bankare dhe jo sipas vërtetimeve të lëshuara nga punëdhënësi. Bazuar në arsyetimin e dhënë më sipër, në paragrafin 11.6 dhe nënparagrafët e tij, Kolegji vlerësoi të drejtë këtë pretendim të subjektit të rivlerësimit dhe në analizën e kryer prej tij për këtë vit, u përfshi si e ardhur nga puna/paga vlera 1406440 lekë, e cila në raport me vlerën prej 1297681 lekësh, të përlllogaritur në analizën financiare nga Komisioni, ndryshon me (+) 108.759 lekë.

**12.2** Në ankim për analizën e Komisionit të vitit 2005, subjekti i rivlerësimit pretendon se nuk janë përfshirë të ardhurat e marra nga bashkëshortja prej 82860 lekësh. Në analizën e Komisionit për vitin 2005, si e ardhur e bashkëshortes është përfshirë vlera prej 61053 lekësh. Referuar të dhënave të plota të *statement-it* të Bankës Procredit<sup>43</sup> për vitin 2005 mbi të ardhurat e bashkëshortes së subjektit të rivlerësimit, rezulton se për të është bërë pagesë nga sigurimet shoqërore për lejen e lindjes në masën 80761 lekë. Kolegji, pasi u njoh me të dhënat e *statement-it* bankar, konsideroi si të ardhur nga bashkëshortja e tij për këtë vit shumën prej 80761 lekësh, e cila e ndryshon analizën financiare me (+) 19.708 lekë.

**12.3** Në referim të arsyetimit të kryer në paragrafët më sipër, lidhur me përlllogaritjen e shpenzimeve të subjektit të rivlerësimit për kostot e jetesës, trupi gjykues i Kolegjit konsideroi në analizën e kryer prej tij për vitin 2005, shpenzimet në masën 328671 lekë, sipas të dhënave të INSTAT-it, të përcjella në Kolegj nga ILDKPKI-ja, ndërsa ato të pretenduara nga subjekti i rivlerësimit, me aktin e ekspertimit, janë në masën 330.000 lekë. Për këtë vit, Kolegjit, referuar analizës së detajuar, i rezulton se Komisioni ka konsideruar si kosto jetese vlerën 459.648 lekë. Nga sa më sipër, referuar kostove të jetesës, analiza e Komisionit në zërin “shpenzime” është zvogëluar me (-) 130.977 lekë.

**12.4** Lidhur me pretendimin e subjektit të rivlerësimit për përlllogaritje të gabuar të shpenzimeve të udhëtimit për vitin 2005, në mungesë të një dokumentacioni që provonte pretendimet e subjektit të rivlerësimit, Kolegji në vijim të arsyetimit të dhënë më sipër, në paragrafin 11.5 dhe nënparagrafët e tij, konsideroi në analizën e tij si shpenzime udhëtimi vlerën e përlllogaritur nga Komisioni në analizën e detajuar financiare, në vlerën prej 240.178 lekësh.

**12.5** Për vitin 2005, subjekti i rivlerësimit gjithashtu ngre pretendimin se nga Komisioni në analizë nuk është marrë në konsideratë shuma prej (+) 1.240.513 lekësh, që rrjedh si diferencë pozitive e vitit 2004, e konsideruar nga subjekti i rivlerësimit si likuiditet i disponuar prej tij në vitin 2005.

**12.6** Trupi gjykues i Kolegjit konstaton se subjekti i rivlerësimit në analizën financiare për vitin 2005, parashtron një metodë të tijën që synon të përfshijë gjendjen e lirë të rezultuar nga analiza financiare e vitit 2004. Referuar deklarimeve periodike të bëra nga subjekti i rivlerësimit për vitin 2004 dhe vitin 2005, rezulton se në vitin 2004 prej tij nuk është deklaruar asnjë kursim në *cash*. Në

<sup>43</sup> *Statement i Bankës Procredit nr. {\*\*\*}, datë 21.02.2018.*

këto kushte, trupi gjykues i Kolegjit, në dritën e jurisprudencës<sup>44</sup> së tij të deritanishme, e konsideron analizën e kryer nga Komisioni për vitin 2005 të drejtë për këtë çështje, duke mos përfshirë gjendjen teorike të likuiditeteve të rezultuara nga analiza financiare e vitit 2004, pasi kjo vlerë<sup>45</sup> ngelet e evidentuar si një kursim potencial përgjatë këtij procesi, për të cilën nuk ka të dhëna (si dokumente bankare etj.) që të dëshmonin ekzistencën e saj në fund të vitit 2005. Kjo metodë e propozuar nga subjekti i rivlerësimit në ankim, nuk rezulton të jetë në përputhje me deklaratimet e interesave privatë dhe pasurorë, të paraqitura më parë tek ILDKPKI-ja, të atij vetë, duke qenë se kursimet nuk janë deklaruar nga subjekti i rivlerësimit në deklaratat periodike të pasurisë sipas kërkesave të ligjit.

**12.7** Për vitin 2005, subjekti i rivlerësimit pretendon se nga Komisioni nuk është marrë në konsideratë gjendja e llogarisë bankare pranë Bankës Intesa Sanpaolo. Për një evidentim të saktë të ndryshimit të likuiditeteve në tërësi të subjektit të rivlerësimit, pjesë e të cilave është edhe gjendja pranë Bankës Intesa Sanpaolo për periudhën 2003-2005, Kolegji mori në analizë të gjitha gjendjet e llogarive bankare të subjektit të rivlerësimit dhe të bashkëshortes në fund të vitit, si dhe të gjitha deklaratat periodike për deklarimin e kursimeve *in cash* që kishin krijuar ndryshimet në likuiditete deri më 31.12.2005. Nga kjo analizë, u konstatua se në ndryshimin e likuiditeteve, në përllogaritjen e Komisionit mungonte vlera prej 16232 lekësh që i korrespondonte gjendjes së llogarisë së subjektit të rivlerësimit në Bankën Raiffesien, më datë 31.12.2004.

**12.8** Kolegji gjithashtu konstatoi se në analizën e ndryshimit të likuiditeteve të përllogaritura nga Komisioni, vlera prej 11000 USD e deklaruar prej subjektit të rivlerësimit në deklaratën fillestare të pasurisë si gjendje, është konvertuar nga Komisioni për efekt të analizës së vitit 2004, me kursin 1 USD = 94,58 lekë, ekuivalente me vlerën në lekë prej 1040.380 lekësh<sup>46</sup>. Ndërsa për efekt të analizës së vitit 2005, e njëjta shumë e deklaruar si kursim në *cash*, 11.000 USD, është konvertuar nga Komisioni me kursin 1 USD = 108,69 lekë, ekuivalente me vlerën në lekë 1.195.590<sup>47</sup>. Ky rivlerësim (nga USD në lekë) ka pakësuar gjendjen e likuiditeteve në lekë të shumës 11.000 USD në masën 155.210<sup>48</sup> lekë në vitin 2004, veprim i cili realisht nuk përfaqëson një pakësim likuiditetesh dhe, nëse do të konsiderohej si i tillë, duhet të shoqërohej në analizë me një veprim korrigjues ku të pasqyroheshin fitimet apo humbjet nga kursi i këmbimit. Për këtë arsye, Kolegji vlerësoi se ndryshimi i likuiditeteve në analizën e vitit 2005 për shumën e deklaruar si kursime në *cash* në USD, duhet të jetë pa efekt financiar, pasi realisht nuk kemi një pakësim të gjendjes në *cash*.

**12.9** Në përfundim, lidhur me analizën e vitit 2005 të kryer nga Komisioni, sipas së cilës subjekti i rivlerësimit ka rezultuar me situatë negative të mbulimit të shpenzimeve e kursimeve me burime të ligjshme në vlerën (-) 551419 lekë, duke konsideruar të gjitha konkluzionet e mësipërme, kjo analizë do të korrigjohet duke përfshirë vlerën (+) 108759 lekë të ardhura nga paga e subjektit të rivlerësimit sipas *statement*-eve bankare; vlerën (+) 19708 lekë të ardhurat e bashkëshortes së subjektit të rivlerësimit nga pagesat e sigurimeve shoqërore; zvogëlimin e zërit të “shpenzimeve” në vlerën 130977 lekë; si dhe vlerën (+) 171.629 lekë që përfaqëson ndryshimin e likuiditeteve për të gjitha llogaritë dhe kursimet në *cash* për vitet 2003-2005. Në total të sa më sipër për vitin 2005, situata financiare e subjektit të rivlerësimit, pas analizës së kryer në Kolegji, rezulton me situatë negative të mbulimit të shpenzimeve me të ardhura të ligjshme në masën (-) 120346 lekë.

<sup>44</sup> Vendimet e Kolegjit nr. 7/2019 (JR), datë 05.04.2019; nr. 11/2019 (JR), datë 22.05.2019; nr. 20/2019 (JR), datë 31.07.2019.

<sup>45</sup> Prej (+) 1.247.705 lekësh.

<sup>46</sup> Për vitin 2004, kursi i aplikuar 1 USD = 94,58 lekë;  $11.000 \text{ USD} \times 94,58 = 1.040.380 \text{ lekë}$ .

<sup>47</sup> Për vitin 2003, kursi i aplikuar 1 USD = 108,69 lekë;  $11.000 \text{ USD} \times 108,69 = 1.195.590 \text{ lekë}$ .

<sup>48</sup>  $1.195.590 \text{ lekë në vitin 2003} - 1.040.380 \text{ lekë në vitin 2004} = 155.210 \text{ lekë}$ .

13 Në analizën financiare të vendimit të Komisionit për vitin 2007, subjekti i rivlerësimit rezulton me mungesë të burimeve të ligjshme në masën prej (-) 697.573 lekësh. Për këtë rezultat të analizës së Komisionit, subjekti i rivlerësimit ka paraqitur kundërshtitë e tij duke pretenduar se:

*[...] Analiza e kryer nga Komisioni për vitin 2007 ka: (i) pasaktësi në përlllogaritjen e shpenzimeve të udhëtimit dhe ato të jetesës; (ii) analiza nuk ka të përfshira të ardhurat e përfituara nga paga e bashkëshortes, si dhe janë të pasakta të ardhurat nga aktiviteti i saj noterial; (iii) në analizë nuk është konsideruar vlera e përfitur nga shitja e automjetit “Land Rover”; (iv) nuk është përfshirë në analizë shuma prej 538.000 lekësh, e cila përfaqëson diferencën pozitive të analizës financiare të vitit 2006 [...].*

13.1 Në referim të arsyetimit të kryer në paragrafët më sipër, lidhur me përlllogaritjen e shpenzimeve të subjektit të rivlerësimit për kostot e jetesës, Kolegji i konsideroi ato në masën 766.896 lekë në analizën e kryer prej tij për vitin 2007, sipas të dhënave të INSTAT-it të përcjella në Kolegj nga ILDKPKI-ja, ndërsa ato të pretenduara nga subjekti i rivlerësimit me aktin e ekspertimit, janë në masën 700.000 lekë. Nga sa më sipër, rezulton se në analizën e Komisionit, referuar kostove të jetesës, analiza e Komisionit në zërin “shpenzime” duhet të rritet me (+) 70.289 lekë.

13.2 Lidhur me pretendimin e subjektit të rivlerësimit për përlllogaritje të gabuar të shpenzimeve të udhëtimit për vitin 2007, trupi gjykues i Kolegjit, në vijim të arsyetimit të dhënë më sipër, në paragrafin 11.5 dhe nënparagrafët e tij dhe për hir të parimit të mospërkeqësimit të situatës së subjektit, konsideroi në analizën e tij si shpenzime udhëtimi vlerën e përlllogaritur nga Komisioni në analizën e detajuar financiare, në vlerën prej 150.000 lekësh.

13.3 Lidhur me pretendimin e subjektit të rivlerësimit për pasaktësi të analizës së Komisionit në drejtim të vlerës së përlllogaritur si të ardhura të përfituara nga aktiviteti si notere i bashkëshortes së tij, në vijim të arsyetimit në paragrafët e mësipërm të këtij vendimi, trupi gjykues i Kolegjit konstaton se në ankim subjekti i rivlerësimit për vitin 2007 pretendon se nuk janë përfshirë të ardhurat nga paga e bashkëshortes në masën prej 141.912 lekësh. Për të konfirmuar këtë vlerë nëpërmjet akteve, Kolegji iu referua pasqyrave financiare të subjektit “Person fizik” si notere të plotësuar për vitin 2007. Gjatë procesit të rivlerësimit, subjekti solli edhe një akt-ekspertimi nga ekspertët B. B. e L. G. Nga analizimi i pasqyrave financiare të vitit 2007, konstatohet se prej subjektit tatimor (notere) B. P., pas rivlerësimit tatimor, nuk janë përfshirë “si shpenzim” pagat për këtë vit dhe vlera në total e shpenzimeve është më e lartë se vetë vlera e pagës së pretenduar. Gjithashtu, edhe në aktet e ekspertimit të sjella me cilësinë e provës nga subjekti i rivlerësimit, nuk janë përfshirë në përlllogaritjet e këtij viti të ardhurat e bashkëshortes nga paga. Në këto kushte, kur nga aktet e administruara përgjatë hetimit administrativ ky pretendim i subjektit të rivlerësimit nuk gjen reflektim në dokumente ligjore e financiare, dhe as duket i logjikshëm krahasuar me të dhënat në zërin shpenzime të bilancit, trupi gjykues i Kolegjit e vlerësoi atë jo të drejtë e të bazuar në prova, duke lënë të pandryshuar analizën e Komisionit për këtë zë.

13.4 Lidhur me të ardhurat e bashkëshortes së tij nga aktiviteti noterial, subjekti i rivlerësimit në ankim pretendon se për vitin 2007, të ardhurat nga aktiviteti noterial i bashkëshortes janë në masën 2.278.805 lekë, vlerë që ndryshon nga analiza e Komisionit vetëm me diferencën prej (+) 22.000 lekësh. Ky pretendim mbështet në aktet e administruara gjatë hetimit administrativ, si:

- Shkresë e Bashkisë Durrës<sup>49</sup>, sipas së cilës rezulton se bashkëshortja e subjektit të rivlerësimit, në deklaratën parashikuese të qarkullimit vjetor 2007, ka deklaruar shumën 1.094.200 lekë.

<sup>49</sup> Shkresa të Bashkisë Durrës nr. {\*\*\*}, datë 18.9.2018, e përcjellë Komisionit nga subjekti i rivlerësimit me përgjigjet e pyetësorin nr. 2.

Bazuar në këtë deklaratë, ky subjekt nga administrata tatimore është klasifikuar në nivelin e xhiros deri në 2 milionë lekë dhe, si e tillë, ka shlyer detyrimet tatimore sipas ligjit të aplikueshëm në shumën totale prej 38000 lekësh (detyrim i caktuar për qarkullimin deri në 2000000 lekë).

- Për vitin ushtrimor 2008, bashkëshortja e subjektit të rivlerësimit, në deklaratën parashikuese të datës 28.02.2008, ndër të tjera, ka deklaruar se qarkullimi vjetor faktik për vitin 2007 ka qenë në shumën prej 2412700 lekësh. Kjo deklaratë e ka ngarkuar atë me detyrimin sipas ligjit për pagimin e tatimit mbi diferencën për xhiron e realizuar, me vlerë prej 22000 lekësh, vlerë e cila figuron e paguar ndaj Bashkisë Durrës, sipas transfertës bankare me nr. {\*\*\*} pranë Bankës Amerikane të Shqipërisë, taksë 1% e xhiros për vitin 2007, datë 11.04.2008.

**13.5.** Në konsideratë të këtyre akteve, si dhe në vijim të arsytimit të bërë më sipër, në paragrafin 11.8 dhe nënparagrafët e tij, mbi modalitetet e pagesave të tatimeve në vitet pasardhës, trupi gjykues i Kolegjit vlerësoi se shuma prej 22000 lekësh duhet të pozicionohet si gjendje *cash* në vitin 2007 dhe si detyrim i shlyer (shpenzim) në vitin 2008, pas deklarimit për xhiron e realizuar. Pas këtij saktësimi, të ardhurat e bashkëshortes së subjektit të rivlerësimit për vitin 2007, rezultojnë në shumën prej 2278805 lekësh (të ndryshuara me + 22000 lekë).

**13.6.** Subjekti i rivlerësimit parashtron se në analizën e Komisionit për vitin 2007 nuk është përfshirë vlera e përfituar nga shitja e automjetit “Land Rover” në masën 1245000 lekë (10000 euro). Trupi gjykues i Kolegjit vëren se nga analiza e dokumenteve në fashikull, rezulton se ky pretendim i subjektit nuk është i bazuar. Kjo vlerë është përfshirë nga Komisioni në analizën e vitit 2007, në zërin “pasuri neto” 1209.100 lekë, së cilës i korrespondon vlera prej 10000 eurosh, konvertuar në lekë me kursin e datës 31.12.2007. Kjo vlerë, nga ana e trupit gjykues të Kolegjit, është përfshirë në analizë me vlerën 1245500 lekë, e cila i korrespondon konvertimit të shumës së shitjes së automjetit prej 10000 eurosh, me kursin sipas datës<sup>50</sup> 22.01.2007, që është data e shitjes së mjetit sipas kontratës së shitjes, ndryshim i cili e korrekton analizën e Komisionit me (+) 36400 lekë.

**13.7.** Për vitin 2007, ashtu si edhe për vitin 2005, subjekti i rivlerësimit pretendon se nuk është përfshirë si gjendje në fillim të vitit shuma prej 538000 lekësh, e cila përfaqëson diferencën pozitive të analizës financiare të vitit 2006. Referuar deklaratimeve periodike të bëra nga subjekti i rivlerësimit për vitin 2006, rezulton se prej tij, në deklaratën periodike të vitit 2006, nuk është deklaruar asnjë kursim në *cash*. Në këto kushte, Kolegji, me të njëjtin arsyetim si edhe për analizën e vitit 2005, si më sipër, në nënparagrafët 12.5 e 12.6, dhe në dritën e përcaktimeve të ligjit nr. 9049/2003, sjell në vëmendje se mospërfshirja prej Komisionit në analizën e vitit 2007 e likuiditeteve të konsideruara si gjendje e lirë nga analiza financiare e vitit 2006, është një veprim i drejtë, pasi kjo vlerë<sup>51</sup> ngelet e evidentuar si një kursim potencial nga analiza financiare e kryer përgjatë këtij procesi, por nuk mund të provojë kursim real, për sa kohë subjekti i rivlerësimit nuk e ka deklaruar atë në deklaratën periodike të vitit 2006.

**13.8.** Në përfundim, lidhur me analizën e vitit 2007 të kryer nga Komisioni, sipas së cilës subjekti i rivlerësimit ka rezultuar me situatë negative të mbulimit të shpenzimeve e kursimeve me burime të ligjshme në vlerën (-) 697.573 lekë, trupi gjykues i Kolegjit çmon se, duke konsideruar të gjitha konkluzionet e mësipërme, kjo analizë duhet korrigjuar duke përfshirë në të: vlerën (+) 22000 lekë, të ardhura nga aktiviteti noterial i bashkëshortes së subjektit të rivlerësimit; vlerën (+) 36400 lekë, të ardhura nga konvertimi sipas datës së transaksionit të shitjes së automjetit “Land Rover”; rritjen e zërit të “shpenzimeve” që u korrespondojnë kostove të jetesës në vlerën 70289 lekë. Në total të sa

<sup>50</sup> Kursi i këmbimit datë 21.01.2007, marrë nga Banka e Shqipërisë: 1 euro = 124,55 lekë.

<sup>51</sup> Prej (+) 538000 lekësh.



më sipër për vitin 2007, situata financiare e subjektit të rivlerësimit, pas analizës së kryer në Kolegj, rezulton me situatë negative të mbulimit të shpenzimeve me të ardhura të ligjshme në masën 709.428 lekë.

- 14 Në analizën financiare të vendimit të Komisionit për vitin 2008, subjekti i rivlerësimit rezulton me mungesë të burimeve të ligjshme në masën prej (-) 557.925 lekësh. Për këtë rezultat të analizës së Komisionit, subjekti i rivlerësimit ka paraqitur kundërshtitë e tij duke pretenduar se:

*[...] Analiza e kryer nga Komisioni për vitin 2008 ka: (i) pasaktësi në përlllogaritjen e shpenzimeve të udhëtimit dhe ato të jetesës; (ii) analiza nuk ka të përfshira të ardhurat e përfituara nga paga e bashkëshortes, si dhe janë të pasakta të ardhurat nga aktiviteti i saj noterial; (iii) ka pasaktësi në ndryshimin e likuiditeteve të këtij viti [...].*

14.1 Në referim të arsyetimit të kryer në paragrafin 11.4 më sipër, lidhur me përlllogaritjen e shpenzimeve të subjektit të rivlerësimit për kostot e jetesës, bazuar në numrin e anëtarëve të familjes së subjektit të rivlerësimit, trupi gjykues i Kolegjit i konsideroi këto shpenzime në vlerën 546.480 lekë, përlllogaritur sipas të dhënave të INSTAT-it, të përcjella në Kolegj nga ILDKPKI-ja. Nga Komisioni, sipas analizës së detajuar financiare, rezulton se kostot e jetesës së subjektit të rivlerësimit për këtë vit janë përlllogaritur në vlerën 696.607 lekë. Nga sa më sipër, rezulton se në analizën e Komisionit, referuar kostove të jetesës, analiza e Komisionit në zërin “shpenzime” duhet të zvogëlohet me (-)150.127 lekë. Sa u përket shpenzimeve të përlllogaritura për udhëtimet e kryera në vitin 2008, për një analizë sa më të plotë të këtij pretendimi, Kolegji bazuar në të dhënat e sistemit TIMS, kreu përlllogaritjen e këtyre shpenzimeve bazuar në metodologjinë e aplikuar prej tij, të shpjeguar në nënparagrafin 11.5.3 më sipër, nga e cila rezultoi se shpenzimet e udhëtimit për këtë vit ishin në vlerën 25.331 lekë, gjë e cila passjell rritjen e vlerës së shpenzimeve të udhëtimit të analizës së Komisionit të vitit 2008 me (+) 694 lekë .

14.2 Lidhur me pretendimin e subjektit të rivlerësimit se për vitin 2008, në analizën financiare të Komisionit, nuk janë përfshirë të ardhurat e përfituara nga bashkëshortja e tij nga paga në masën prej 151.668 lekësh, për të gjetur gjurmë të evidentimit në akte të kësaj vlere, Kolegji iu referua pasqyrave financiare të subjektit “Person fizik”, si notere të plotësuara për vitin 2008. Në vijim të shpjegimeve e qëndrimeve të mbajtura në paragrafin më sipër 11.6 dhe nënparagrafët e tij për të ardhurat e aktivitetit si notere për vitet 2008, 2009, 2010, 2011 (*vite për të cilat nga organet tatimore është kryer një vlerësim tatimor dhe kemi zyrtarisht të ardhura dhe pasqyra financiare të konfirmuara nga organet e tatimit*), Kolegji vlerëson se paga e pretenduar për vitin 2008, prej 151.668 lekësh, duhet të konsiderohet si e ardhur, pasi kjo vlerë është përfshirë si shpenzim te “pasqyrat financiare” të subjektit tatimor (bashkëshortes së subjektit të rivlerësimit) për vitin 2008. Për këtë shkak, analiza e detajuar e Komisionit duhet korrektuar në vlerën prej (+) 151.668 lekësh.

14.3 Në ankim, për vitin 2008, subjekti i rivlerësimit shpreh se përlllogaritja e të ardhurave nga aktiviteti noterial i bashkëshortes për këtë vit nuk ka qenë e saktë, pasi nga fitimi janë zbritur më shumë detyrime tatimore nga janë paguar realisht. Lidhur me këtë pretendim të subjektit të rivlerësimit, në vijim të arsyetimit të bërë në paragrafin 11.8 më sipër dhe nënparagrafët e tij, te të cilët është argumentuar se gjendet e drejtë marrja në konsideratë e shpenzimeve për tatime sipas kohës kur këto pagesa janë kryer, Kolegji, pas përlllogaritjeve mbi këtë metodologji të fitimit real të këtij viti, e konsideroi atë në vlerën 3.018.194 lekë, e cila korrekton analizën e detajuar të Komisionit për këtë vit në vlerën (+) 176.419 lekë. Për të vijuar arsyetimin e pranuar më sipër mbi zhvendosjen e detyrimeve në vitin pasardhës sipas datës së pagesës së tyre nga ky fitim, Kolegji vlerës (+) 176.419 lekë i zbriti vlerën 22.000 lekë, e cila u korrespondon detyrimeve tatimore të paguara në këtë vit që ka të bëjë me detyrimet e vitit paraardhës 2007. Pas kësaj përlllogaritjeje,

shifra prej 2841775 lekësh, e llogaritur nga Komisioni si e ardhur nga aktiviteti noterial për vitin 2008, është korrektuar me vlerën (+) 154419 lekë.

**14.4** Lidhur me ndryshimin e likuiditeteve të vitit 2008, subjekti i rivlerësimit pretendon se ato nuk janë përlllogaritur saktë prej Komisionit, duke pretenduar me aktin e ekspertimit ndryshim likuiditeti në masën +1.007.283 lekë. Sipas analizës së detajuar të Komisionit, rezulton se ndryshimi i likuiditeteve është konsideruar në masën (+) 1.308.746 lekë. Duke u nisur nga këto diferenca midis vlerës së përlllogaritur nga Komisioni dhe asaj të pretenduar nga subjekti i rivlerësimit në ankim, Kolegji kreu një analizë të pavarur për të përlllogaritur ndryshimin e likuiditeteve në këtë vit, duke iu referuar deklaratave periodike të pasurisë së subjektit të rivlerësimit për deklarimin e gjendjes *cash* dhe të gjendjeve të llogarive bankare në fillim dhe në fund të vitit 2008. Nga kjo analizë, rezulton se ndryshimet mes analizës së kryer në Kolegji me atë të subjektit të rivlerësimit janë:

- Gjendja e llogarisë në euro pranë Bankës Intesa Sanpaolo është në vlerën 1.205,97 euro, e konvertuar me kursin mesatar të vitit 2008 (1 euro = 123,18 lekë = 148.554 lekë), e cila në akt-ekspertimin e subjektit të rivlerësimit është llogaritur në vlerën 146.745 lekë.
- Në akt-ekspertimin e paraqitur nga subjekti i rivlerësimit, nuk janë përfshirë ndryshimet e likuiditeteve të tri llogarive, e përkatësisht: llogarisë së subjektit pranë Bankës Raiffeisen, me vlerë 1426 lekë; nuk janë përfshirë gjendjet e llogarive të bashkëshortes pranë Bankës Intesa Sanpaolo, me vlerë 17.854 lekë dhe pranë BKT-së me gjendje 16.103 lekë. Ndërkohë, gjendja e llogarisë së bashkëshortes pranë BKT-së, me vlerë 16.103 lekë, konstatohet se nuk është përfshirë as në analizën e Komisionit.
- Në analizën e akt-ekspertimit të subjektit të rivlerësimit është shtuar shuma 25.000 lekë, si gjendje llogarie pranë Bankës Procredit<sup>52</sup> në emër të bashkëshortes së subjektit të rivlerësimit, kur ndërkohë kjo llogari në datën 31.12.2008 rezulton me vlerën 0 lekë.
- Në analizën e akt-ekspertimit të subjektit të rivlerësimit konstatohet se nuk është përfshirë shtesa e gjendjes së *cash*-it në emër të bashkëshortes së subjektit të rivlerësimit, të deklaruar prej saj në deklaratën periodike të pasurisë për vitin 2008<sup>53</sup>, deklaruar kursim në *cash* vlerën 2.500 euro (konvertuar me kursin e fundit të vitit, vlera ekuivalente me 307.956 lekë), shumë e disponuar në *cash*, e grumbulluar nga bashkëshortja si notere në Durrës gjatë vitit 2008. Është pikërisht kjo vlerë e papërfshirë në analizën e ekspertit të subjektit të rivlerësimit, elementi që përbën diferencën më të madhe që rezulton në zërin “Ndryshimi i likuiditeteve”.

Në përfundim të kësaj analize, trupi gjykues i Kolegjit konsideroi si ndryshim të likuiditeteve për vitin 2008 vlerën 1.325.208 lekë, e cila, në ndryshim nga analiza e Komisionit, e korrekton analizën financiare të subjektit të rivlerësimit me vlerën (-) 16.462 lekë.

**14.5** Në përfundim, lidhur me analizën e vitit 2008, të kryer nga Komisioni, sipas së cilës subjekti i rivlerësimit ka rezultuar me situatë negative të mbulimit të shpenzimeve e kursimeve me burime të ligjshme në vlerën (-) 557.925 lekë, Kolegji çmon se, duke konsideruar të gjitha konkluzionet e mësipërme, kjo analizë duhet korrektuar duke përfshirë në të: vlerën (+) 151.668 lekë, si të ardhura nga paga e bashkëshortes, dhe (+) 154.419 lekë nga aktiviteti noterial i bashkëshortes së subjektit të rivlerësimit; duke rritur shpenzimet e udhëtimit me vlerën (+) 694 lekë; zvogëlimin e zërit të “shpenzimeve” që u korrespondojnë kostove të jetesës me vlerën (-) 150.127 lekë, si dhe ndryshimin e likuiditeteve në këtë vit me (-) 16.462 lekë. Në total të sa më sipër, për vitin 2008, situata financiare e subjektit të rivlerësimit, pas analizës së kryer në Kolegji,

<sup>52</sup> Gjendja e llogarisë bankare pranë Procredit Bank, në date 31.12.2008

<sup>53</sup> Deklarata periodike e vitit 2010, “Seksioni të ardhura dhe angazhime në veprimtari Publike” shtese “cash” në deklaratën e vitit 2008. ((aneksi nr.1 bashkëlidhur relacionit).

rezulton përsëri me situatë negative të mbulimit të shpenzimeve me të ardhura të ligjshme në masën (-) 118867 lekë.

- 15 Në analizën financiare të vendimit të Komisionit për vitin 2010, subjekti i rivlerësimit rezulton me mungesë të burimeve të ligjshme në masën prej (-) 688840 lekësh. Për këtë rezultat të analizës së Komisionit, subjekti i rivlerësimit ka paraqitur kundërshtitë e tij duke pretenduar se:

*[...] Analiza e kryer nga Komisioni për vitin 2010, ka: (i) pasaktësi në përllogaritjen e shpenzimeve të udhëtimit dhe ato të jetesës; (ii) analiza nuk ka të përfshira të ardhurat e përfituara nga paga e bashkëshortes, si dhe janë të pasakta të ardhurat nga aktiviteti i saj noterial; (iii) nuk janë konsideruar të plota të ardhurat e këtij viti nga qiraja; (iv) duhet korrigjohet vlera e shitjes, përfshirë në analizë për shitjen e automjetit “Dimler Craysler” dhe vlerës së blerjes së automjetit “Mercedes Benz”; (v) ka pasaktësi në ndryshimin e likuiditeteve të këtij viti.*

15.1 Sa i përket përllogaritjes së shpenzimeve të jetesës dhe të udhëtimeve, në referim të arsytimit në paragrafët 11.4 dhe 11.5 më sipër, si dhe në nënparagrafët e tyre, trupi gjykues i Kolegjit, në analizën e kryer prej tij për vitin 2010, bazuar në numrin e anëtarëve të familjes së subjektit të rivlerësimit, i konsideroi këto shpenzime në vlerën 546480 lekë, të cilat janë përllogaritur sipas të dhënave të INSTAT-it, të përcjella në Kolegj nga ILDKPKI-ja, kundrejt 696.607 lekëve, të përllogaritura nga Komisioni sipas analizës së detajuar financiare. Nga sa më sipër, rezulton se në analizën e Komisionit, referuar kostove të jetesës, analiza e Komisionit në zërin “shpenzime” edhe për vitin 2010 duhet të zvogëlohet me (-) 150.127 lekë. Lidhur me shpenzimet e udhëtimit për vitin 2010, trupi gjykues i Kolegjit, bazuar në të dhënat e sistemit TIMS për këtë vit, të administruara gjatë hetimit administrativ, dhe metodologjisë së aplikuar tanimë në Kolegj, i përllogarit ato në vlerën 250.695 lekë, gjë e cila passjell uljen e vlerës së shpenzimeve të udhëtimit të analizës së Komisionit të vitit 2010 me (-) 151.854 lekë.

15.2 Lidhur me pretendimin tjetër të subjektit të rivlerësimit se, për vitin 2010, në analizën financiare të Komisionit, duhet të ishin përfshirë të ardhurat e përfituara nga bashkëshortja e tij nga paga, në masën prej 146.000 lekësh, referuar pasqyrave financiare të subjektit “Person fizik”, notere, të plotësuara për vitin 2010, në vijim të qëndrimeve të mbajtura në paragrafët 11.6 dhe 11.8 dhe nënparagrafët e tyre për të ardhurat e aktivitetit të personit të lidhur si notere për vitet 2008, 2009, 2010, 2011 (vite për të cilat nga organet tatimore është kryer një vlerësim tatimor dhe kemi zyrtarisht të ardhura dhe pasqyra financiare të konfirmuara nga organet e tatimit), trupi gjykues i Kolegjit vlerësoi se ky pretendim i subjektit është i drejtë, pasi kjo vlerë është përfshirë si shpenzim të “pasqyrat financiare” të subjektit tatimor (bashkëshortes së subjektit të rivlerësimit) për vitin 2010. Për këtë shkak, analiza e detajuar e Komisionit duhet korrigjohet në vlerën prej (+) 146.000 lekësh. Gjithashtu Kolegji kreu edhe kontrollin e përllogaritjes së fitimit nga aktiviteti i bashkëshortes për këtë vit, duke përfshirë në këtë vit likuidimin e detyrimeve tatimore të vitit paraardhës, veprim i cili ka passjellë rritjen e shpenzimeve të këtij viti me (+) 5000 lekë.

15.3 Subjekti i rivlerësimit pretendon se të ardhurat e tij nga qiraja, për vitin 2010, nuk janë konsideruar të plota, e sipas përllogaritjes së tij duhet të jenë në masën prej 560.000 lekësh, që janë ekuivalenti i 4000 eurove. Në analizën e detajuar të Komisionit, e ardhura nga qiraja për këtë vit është konsideruar në vlerën 416.430 lekë. Në analizë të akteve të administruara nga Komisioni, konkretisht edhe kontratës së qirasë<sup>54</sup> së datës 10.09.2009, rezulton se ajo ka afat kohor një- (1-) vjeçar, duke filluar më datë 01.10.2009, e datë përfundimi 01.10.2010. Rezulton që qiramarrësi e

<sup>54</sup> Kontratë qiraje, datë 10.09.2009, ndërmjet Ferdinand Elezi me {\*\*\*} dhe “{\*\*\*}” dhe pagesat pranë Bankës Intesa Sanpaolo.

ka paguar qiranë nëpërmjet sistemit bankar në llogarinë e subjektit të rivlerësimit. Sipas vërtetimeve bankare, në llogarinë bankare pranë Bankës Intesa Sanpaolo, rezulton se në vitin 2010, subjekti i rivlerësimit ka pasur të kredituar si të ardhur nga qiraja vetëm shumën prej 2000 eurosh (*me përshkrim: qira muaji janar, shkurt, mars dhe prill*), ndërsa për muajt e tjerë të këtij viti nuk ka asnjë veprim kreditues që të vërtetojë derdhjen e të ardhurave. Në deklaratën periodike të pasurisë për vitin 2010, subjekti i rivlerësimit ka deklaruar të ardhura nga qiraja e banesës në Tiranë gjatë vitit 2010, shumën prej 3000 eurosh, ndërsa gjatë hetimit administrativ, subjekti i rivlerësimit ka pretenduar se në fakt, të ardhurat për vitin 2010 nga qiraja, janë në shumën 4000 euro dhe se deklarimi në deklaratën periodike vjetore ka qenë i gabuar. Trupi gjykues i Kolegjit, së pari, vëren se duke qenë se subjekti i rivlerësimit nuk provon përfitimin e kësaj shume nëpërmjet sistemit bankar për vlerën mbi 2000 euro, Komisioni duhet të kishte analizuar pretendimet e tij në hetim në kontekstin e faktit që ato janë deklarative. Në dritën e parimit të mospërkeqësimit të situatës së subjektit të rivlerësimit në ankim, trupi gjykues i Kolegjit vëren se analiza do të duhet të qëndrojë te vlera e pranuar në Komision dhe çmon ta sjellë në vëmendje edhe këtë element në frymën e shtjelluar më sipër, në paragrafët 10.2.3 dhe 11.8.6, si tërheqje vëmendjeje për Komisionin, pa e shoqëruar me pasoja për përllogaritjen e burimeve të ligjshme të subjektit për vitin 2010. Në të njëjtën kohë, pretendimi i subjektit se të ardhurat në vitin 2010 do të duhet të përllogariteshin në vlerën 4000 euro, në kushtet kur këtë shumë nuk e ka deklaruar në deklaratat periodike vjetore dhe as provuar me dokumentacion, është i pabazuar. Për pasojë, trupi gjykues në analizë do t'i qëndrojë vlerës së pranuar nga Komisioni, pavarësisht rezervave të theksuara më sipër, në shumën prej 3000 eurosh, ekuivalente me shumën 416430 lekë.

**15.4** Lidhur me pretendimin e subjektit të rivlerësimit për sa u përket vlerave të përfshira në analizë për shitblerjet e automjeteve në vitin 2010, Kolegji konstaton se, sipas Komisionit, shitja e makinës tip “Daimler Chrysler”, me targë {\*\*\*}, është përfshirë në analizë me vlerën 970000 lekë, ndërsa sipas kontratës<sup>55</sup> së datës 06.11.2010, vlera e shitjes është 980000 lekë. Në mungesë të analizës së Komisionit për uljen e vlerës prej 10000 lekësh dhe të analizës në drejtim të përllogaritjes së tatimit mbi fitimin [nëse ishte rasti të zbatohet], trupi gjykues i Kolegjit përllogarit vlerën e përcaktuar në kontratë. Së dyti, lidhur me automjetin e dytë, blerë nga subjekti më 22.11.2010<sup>56</sup>, Komisioni ka përllogaritur çmimin 2152975 lekë, që pasqyron vlerën pas zbritjes së TVSh-së në masën 19% të vlerës së faturës së këtij automjeti [vlerën 14000 euro]. Nga përllogaritja aritmetike e çmimit të blerjes së automjetit, pasi zbritet 19% nga vlera e deklaruar në kontratë dhe pagesa e importit [doganës] në hyrje në Shqipëri, rezultojnë vlerat që vijojnë: 14000 euro – 19% taksa dhe TVSh = 11340 euro ose 11500 – sipas deklaratës së subjektit – ose 1596315 lekë<sup>57</sup>. Më tej, 1596315 + shpenzime për taksat doganore prej 489.093 lekësh = 2085408 lekë. Pra, vlera prej 2152975 lekësh, e përcaktuar nga Komisioni, duhet të korrigjohet me vlerën prej 2085408 lekësh, e cila e ndryshon analizën e Komisionit duke zvogëluar shpenzimet me shumën prej 67567 lekësh.

**15.5** Subjekti i rivlerësimit pretendon se shpenzimet e vitit 2010 nuk janë përllogaritur saktë prej Komisionit edhe në lidhje me ndryshimin e likuiditeteve, që sipas tij janë në masën (+) 292.905 lekë. Nga analiza e detajuar e Komisionit, rezulton se ndryshimi i likuiditeteve është konsideruar në masën (+) 282.671 lekë. Duke iu referuar deklaratave periodike të pasurisë së subjektit të rivlerësimit për deklarimin e gjendjes *cash*, dhe gjendjeve të llogarive bankare në fillim dhe në fund

<sup>55</sup> Kontratë shitblerjeje automjeti me nr. {\*\*\*} rep., nr. {\*\*\*} kol., e datës 06.11.2010, ndërmjet shitësit Ferdinand Elezi dhe blerësit F. C..

<sup>56</sup> Blerje autoveture, me targë {\*\*\*}. Kontrata dhe fatura lëshuar nga {\*\*\*}, e datës 22.11.2010 dhe deklarimin doganor në Shqipëri.

<sup>57</sup> Kursi i këmbimit 1 euro = 138,81 lekë, sipas Bankës së Shqipërisë:

[https://www.bankofalbania.org/Tregjet/Kursi\\_zyrtar\\_i\\_kembimit/](https://www.bankofalbania.org/Tregjet/Kursi_zyrtar_i_kembimit/)

të vitit 2010, trupi gjykues i Kolegjit vëren se ndryshimi midis analizës së paraqitur nga subjekti dhe analizës së Komisionit është në vlerën (-) 12.679 lekë, ndërsa ndryshimi i analizës së Kolegjit me atë të akt-ekspertimit të sjellë nga subjekti i rivlerësimit është (-) 22.913 lekë. Kjo diferencë vjen si rrjedhojë e pasqyrimit të gjendjeve të llogarive bankare në Bankën Intesa Sanpaolo, prej 1.086 lekësh, Bankën Raiffeisen prej 1.426 lekësh, Bankën Societe Generale prej (-) 19.349 lekësh dhe një gjendjeje shtese prej 1.600 lekësh, e pretenduar në Bankën ProCredit. Diferenca midis analizës së Kolegjit dhe analizës së Komisionit vjen si rrjedhojë e rivlerësimit të *cash*-it të deklaruar në valutë në vitin 2009, i konvertuar nga Komisioni me kursin e këmbimit të vitit 2010 [passjell një diferencë prej 14.100 lekësh] dhe përlllogaritja e gjendjes së llogarisë në Bankën Kombëtare Tregtare, me vlerë 6.676 lekë, që mungon në analizën e Komisionit.

Në përfundim, nga kjo përlllogaritje e gjendjes së likuiditeteve të subjektit të rivlerësimit për vitin 2010, situata e tij financiare për këtë vit ndryshon me (-) 12.679 lekë.

**15.6** Në përfundim, lidhur me analizën e vitit 2010 të kryer nga Komisioni, sipas së cilës subjekti i rivlerësimit ka rezultuar me situatë negative të mbulimit të shpenzimeve e kursimeve me burime të ligjshme në vlerën (-) 688.840 lekë, trupi gjykues i Kolegjit çmon se duke konsideruar të gjitha konkluzionet e mësipërme, kjo analizë duhet korrigjuar duke përfshirë në të: zvogëlimin e shpenzimeve me vlerën (-) 150.127 lekë për kostot e jetesës dhe me (-) 151.854 lekë shpenzimet e udhëtimit; duke shtuar si të ardhura vlerën (+) 146.000 lekë si të ardhura nga paga e bashkëshortes; rritjen e shpenzimeve me vlerën 5.000 lekë nga aktiviteti noterial i bashkëshortes së subjektit të rivlerësimit; duke zvogëluar shpenzimet nga shitblerjet e automjeteve brenda këtij viti në total prej (-) 97.567 lekësh; si dhe ndryshimin e likuiditeteve në këtë vit me (+) 12.679 lekë. Në konkluzion të sa më sipër për vitin 2010, situata financiare e subjektit të rivlerësimit, pas analizës së kryer në Kolegj, rezulton përsëri me situatë negative të mbulimit të shpenzimeve me të ardhura të ligjshme, në masën (-) 135.611 lekë kundrejt vlerës prej (-) 688.840 lekësh, të konstatuar prej Komisionit.

- 16 Në analizën financiare të vendimit të Komisionit për vitin 2013, subjekti i rivlerësimit rezulton me mungesë të burimeve të ligjshme në masën prej (-) 220.172 lekësh. Për këtë rezultat të analizës së Komisionit, subjekti i rivlerësimit ka paraqitur kundërshtitë e tij duke pretenduar se:

*[...] Analiza e kryer nga Komisioni për vitin 2013 ka munguar të përfshijë: (i) tek të ardhurat e fituara nga puna, të ardhurat e pagesave që i janë bërë subjektit të rivlerësimit për transportin; (ii) ka pasaktësi në drejtim të saktësisit të fitimit nga aktiviteti noterial i bashkëshortes; (iii) pasaktësi në përlllogaritjen e shpenzimeve të udhëtimit dhe atyre të jetesës; (iv) nuk janë konsideruar të plota të ardhurat e këtij viti nga qiraja [...]*

**16.1** Në ankim, subjekti i rivlerësimit parashtron se si pjesë e të ardhurave të përfituara nga puna duhet të jenë edhe ato të marra prej tij në cilësinë e drejtuesit të prokurorisë, si “bonus” për transportin. Në vijim të shpjegimit dhe arsytimit të dhënë në nënparagrafin 11.6.2 të këtij vendimi, trupi gjykues i Kolegjit, pa dashur të përsëritë sa më sipër, thekson se pagesat e bonusit të karburantit nga punëdhënësi, prezumohet se nevojiten për të rimbursuar shpenzime transporti në funksion të ushtrimit të detyrës. Pavarësisht se vlera e tyre, në analizën e vitit 2013, është pa pasoja themelore për rezultatin financiar të vitit, trajtimi i tyre nga subjekti si *bonus*, dëshmon se subjekti duhet të kishte konsideruar mospërfitimin e tyre.

**16.2** Lidhur me pretendimet e subjektit të rivlerësimit për vitin 2013 se ka pasaktësi në drejtim të fitimit nga aktivitet noterial i bashkëshortes, në analizë të pasqyrave financiare të plotësuar nga personi fizik [“Notere”] për aktivitetin financiar të vitit 2013, si dhe akt-kontrollet e organeve tatimore për këtë vit, trupi gjykues i Kolegjit vëren se fitimi i pranuar nga organet tatimore është në vlerën 2.240.417 lekë, ndërsa në analizën e Komisionit referohet vlera prej 2.141.775 lekësh. Në

vijim të analizës së kryer më sipër, në paragrafin 11.8.7, në kushtet kur Komisioni ka pranuar vlerën e fitimeve sipas rivlerësimit të subjektit tatimpagues [personi i lidhur] sipas dokumentacionit të administruar në fashikull, vlera e identifikuar si fitim i aktivitetit noterial në Komision do të duhet të ishte 2.240.417 lekë, ose plus (+) 98.642 lekë, si pasojë e rivlerësimit dhe shtyrjes së shlyerjes së detyrimeve (shpjeguar në paragrafin 11.8 e nënparagrafët e tij), për të cilat në këtë vit është paguar vlera (-) 92.248 lekë.

**16.3** Subjekti i rivlerësimit ngre pretendime edhe për këtë vit për kostot e jetesës dhe shpenzimet e udhëtimit nga Komisioni. Në referim të arsytimit të kryer në paragrafët 11.4 e 11.5 dhe nënparagrafët e tyre, nga përlllogaritja sipas të dhënave të INSTAT-it, të përcjella në Kolegj nga ILDKPKI-ja, bazuar në numrin e anëtarëve të familjes së subjektit të rivlerësimit, këto shpenzime do të duhet të ishin në vlerën 564.096 lekë kundrejt vlerës 696.607 lekë, sipas analizës së detajuar financiare të Komisionit [bazuar në baraspjesëtim të totalit]. Nga sa më sipër, rezulton se në analizën e Komisionit, referuar kostove të jetesës, analiza e Komisionit në zërin “shpenzime” edhe për vitin 2013 duhet të zvogëlohet me (-) 132.511 lekë. Lidhur me shpenzimet e udhëtimeve të kryera në vitin 2013, pasi analizoi të dhënat e sistemit TIMS për këtë vit, të administruara gjatë hetimit administrativ, trupi gjykues i Kolegjit kreu përlllogaritjen e këtyre shpenzimeve, bazuar në metodologjinë e aplikuar e të shpjeguar më sipër, në paragrafin 11.5.3. Nga kjo përlllogaritje, rezultoi se shpenzimet e udhëtimit për këtë vit ishin në vlerën 514.979 lekë, gjë e cila passjell uljen e vlerës së shpenzimeve të udhëtimit të analizës së Komisionit të vitit 2013, me (+) 134.894 lekë.

**16.4** Subjekti i rivlerësimit pretendon se në analizën e Komisionit nuk janë përfshirë të ardhurat e 2 muaj qiraje, me vlerë në total 98.000 lekë për vitin 2013, të cilat qiramarrësi ia ka paguar nëpërmjet sistemit bankar. Në analizë të këtij pretendimi, trupi gjykues i Kolegjit konstatoi se nga aktet e administruara përgjatë hetimit, kontrata e qirasë ka pasur afat 1-vjeçar, deri më 31.01.2012<sup>58</sup>. Trupi gjykues i Kolegjit konstaton se nga dokumentacioni rezulton që z. F. R. ka paguar rregullisht shumat mujore prej 350 eurosh në llogari të subjektit të rivlerësimit përgjatë vitit 2012, si dhe dy muaj në vitin 2013. Nga ana tjetër, qëndrimi i Komisionit për të mos përfshirë te të ardhurat me burime të ligjshme ato nga qiraja në vitin 2013, pasi subjekti ka kryer pagesën e detyrimeve tatimore vetëm katër (4) vjet më pas, teksa kishte filluar procesi i rivlerësimit, është i drejtë dhe në përputhje me përcaktimet e nenit D të Kushtetutës, ligjit<sup>59</sup> dhe jurisprudencës së mëparshme të Kolegjit në çështje të tjera<sup>60</sup>. Për këtë arsye, ky pretendim i subjektit të rivlerësimit nuk u pranua.

**16.5** Në përfundim, për analizën e vitit 2013 të kryer nga Komisioni, sipas së cilës subjekti i rivlerësimit ka rezultuar me situatë negative të mbulimit të shpenzimeve e kursimeve me burime të ligjshme në vlerën (-) 220.172 lekë, trupi gjykues i Kolegjit çmon se, duke konsideruar të gjitha konkluzionet e mësipërme, bazuar në pretendimet në ankim përkundër elementeve të pretendimeve të subjektit të pranuar nga Komisioni në procesin e hetimit administrativ, kjo analizë do të duhet të korrektohej, duke përfshirë uljen e shpenzimeve të jetesës në vlerën (-)132.511 lekë, me (-)134.894 lekë për shpenzimet e udhëtimit, shtimin si të ardhur vlerën (+) 98.642 lekë nga aktiviteti noterial i bashkëshortes së subjektit të rivlerësimit dhe rritjen e shpenzimeve të këtij aktiviteti me vlerën

<sup>58</sup> Kontratë qiramarrjeje, datë 01.02.2011, ndërmjet Ferdinand Elezi, F. R. me ndërmjetës “{\*\*\*}”.

<sup>59</sup> Neni D, pika 3 parashikon: “[...] Pasuri të ligjshme për qëllimet e këtij ligji konsiderohen të ardhurat që janë deklaruar dhe për të cilat janë paguar detyrimet tatimore”. Neni 30 i ligjit nr. 84/2016 parashikon: “Objekti i vlerësimit të pasurisë është deklarimi dhe kontrolli i pasurive, i ligjshmërisë së burimit të krijimit të tyre, i përmbushjes së detyrimeve financiare, përfshirë interesat privatë për subjektin e rivlerësimit dhe për personat e lidhur të tij”.

<sup>60</sup> Shih vendimet JR/6/2019, paragrafi 21.12, vendimi JR/19/2019, paragrafi 22.13, vendimin JR/3/2018 paragrafi 24, vendimin JR/7/2018 paragrafi 52, JR/32/2019 paragrafi 56, JR 05/2020 paragrafi 41.9 dhe së fundmi, JR/23/2020 paragrafët 24.8 dhe 24.13.

92.248 lekë nga tatimet e spostuara. Për shkak të sa më sipër, situata financiare e subjektit të rivlerësimit, pas analizës së kryer në Kolegj për vitin 2013, rezulton me situatë pozitive të mbulimit të shpenzimeve me të ardhura të ligjshme në masën (+) 54.709 lekë.

- 17 Në analizën financiare të vendimit të Komisionit për vitin 2014, subjekti i rivlerësimit rezulton me mungesë të burimeve të ligjshme në masën prej (-)158.376 lekësh. Për këtë rezultat të analizës së Komisionit, subjekti i rivlerësimit ka paraqitur kundërshtitë e tij, duke pretenduar se:

*[...] Analiza e kryer nga Komisioni për vitin 2014: (i) ka pasaktësi në drejtim të saktësisimit të fitimit nga aktivitet noterial i bashkëshortes; (ii) pasaktësi në përlllogaritjen e shpenzimeve të udhëtimit dhe ato të jetesës; (iii) nuk është përlllogaritur saktë në analizë ndryshimi i likuiditeteve në këtë vit [...].*

17.1 Duke ndjekur të njëjtin arsyetim si edhe më sipër, në paragrafët 11.4 e 11.5 dhe nënparagrafët e tyre, në analizën e kryer nga trupi gjykues i Kolegjit për vitin 2014, sipas të dhënave të INSTAT-it, të përcjella në Kolegj nga ILDKPKI-ja, bazuar në numrin e anëtarëve të familjes së subjektit të rivlerësimit, shpenzimet e jetesës përlllogariten në vlerën 879.992 lekë, përkundër 696.607 lekëve të përlllogaritur nga Komisioni. Kjo passjell që në analizën e Komisionit, kostot e jetesës duhet të shtohen me (+) 183.511 lekë. Lidhur me kostot e përlllogaritura për udhëtimet e kryera në vitin 2014, nga analiza e kryer nga trupi gjykues i Kolegjit, bazuar në të dhënat e sistemit TIMS për këtë vit, të administruara gjatë hetimit administrativ, rezultoi se shpenzimet e udhëtimit për këtë vit ishin në vlerën 735.300 lekë, gjë e cila passjell uljen e vlerës së shpenzimeve të udhëtimit të analizës së Komisionit të vitit 2014 me (-) 232.860 lekë.

17.2 Në drejtim të analizimit të pretendimit të subjektit të rivlerësimit për identifikim të saktë të të ardhurave nga aktiviteti noterial i bashkëshortes në vitin 2014, trupi gjykues i Kolegjit, në vijim të arsytimit dhe argumenteve të dhëna më sipër, në paragrafin 11.8 dhe nënparagrafët e tij, kreu një analizë të plotë të pasqyrave financiare dhe të akteve të organeve tatimore dhe konstatoi se vlera e shpenzimeve të analizës financiare duhet të rritet me vlerën e detyrimeve tatimore të paguara në këtë vit, si pasojë e spostimit të tyre në vlerën (+) 164.642 lekë.

17.3 Për sa i përket ndryshimit të likuiditeteve në këtë vit, në analizë të pretendimeve të subjektit të rivlerësimit dhe deklaratës periodike vjetore të plotësuar prej tij për vitin 2014, trupi gjykues konstatoi se subjekti ka deklaruar në seksionin e pasurive dhe burimeve të krijimit: *[...] nga shuma e disponuar në cash 1.800.000 lekë, e deklaruar nga vitet e mëparshme, mbetur në cash 1.400.000 lekë dhe janë konvertuar në 2014 në shumën 10.000 euro, e cila mbahet cash [...].* Nga ky deklaram i subjektit të rivlerësimit në deklaratën periodike, trupi gjykues i Kolegjit konstaton se gjendja e cash-it e deklaruar vite më parë (në periudhën 2008-2013) është pakësuar me 400.000 lekë dhe kanë mbetur vetëm 1.400.000 lekë, të cilat janë konvertuar dhe mbahen në gjendje cash në valutë në shumën 10.000 euro. Trupi gjykues konstaton se ky pakësim i cash-it, në vlerën (-) 400.000 lekë nuk është përfshirë në analizën financiare për vitin 2014 të bërë nga Komisioni, por është përcaktuar një diferencë e likuiditeteve me vlerën (-) 68.205 lekë. Në këto kushte, trupi gjykues i Kolegjit, për vitin 2014, ka korrektuar analizën e detajuar të Komisionit në drejtim të ndryshimit të likuiditeteve, duke korrektuar ndryshimin e likuiditeteve me (-) 334.700 lekë.

17.4 Në përfundim, për analizën e vitit 2014, të kryer nga Komisioni, sipas së cilës subjekti i rivlerësimit ka rezultuar me situatë negative të mbulimit të shpenzimeve e kursimeve me burime të ligjshme në vlerën (-)158.376 lekë, trupi gjykues i Kolegjit çmon se duke konsideruar të gjitha konkluzionet e mësipërme, kjo analizë duhet korrektuar përkatësisht: duke rritur shpenzimet me vlerën (+) 183.385 lekë për kostot e jetesës, duke ulur shpenzimet e udhëtimit me vlerën (-) 232.860 lekë, duke rritur shpenzimet e aktivitetit noterial të bashkëshortes vlerën 164.642 lekë nga tatimet e

spostuara dhe, së fundmi, duke korrektoar ndryshimin e likuiditeteve në vlerën (-) 334.700 lekë. Në total të sa më sipër, për vitin 2014, situata financiare e subjektit të rivlerësimit, pas analizës së kryer në Kolegj, rezulton me situatë pozitive të mbulimit të shpenzimeve me të ardhura të ligjshme në masën (+) 61.157 lekë.

- 18** Në analizën financiare të vendimit të Komisionit për vitin 2016, subjekti i rivlerësimit rezulton me mungesë të burimeve të ligjshme në masën prej (-) 170.634 lekësh. Për këtë rezultat të analizës së Komisionit, subjekti i rivlerësimit ka paraqitur kundërshtitë e tij, duke pretenduar se:

*[...] Analiza e kryer nga Komisioni për vitin 2016: (i) ka pasaktësi në drejtim të saktësisimit të fitimit nga aktiviteti noterial i bashkëshortes; (ii) pasaktësi në përllogaritjen e shpenzimeve të udhëtimit dhe ato të jetesës; (iii) nuk është përllogaritur saktë në analizë ndryshimi i likuiditeteve në këtë vit; (iv) në këtë vit janë përfshirë gabimisht shpenzime për mobilim në shumën 500.000 lekë [...].*

**18.1** Në funksion të pretendimit të subjektit të rivlerësimit për identifikim të saktë të të ardhurave nga aktiviteti noterial i bashkëshortes në vitin 2016, trupi gjykues i Kolegjit, në vijim të arsyetimit dhe argumenteve të dhëna në paragrafin 11.8 e nënparagrafët e tij, kreu një analizë të plotë të pasqyrave financiare dhe të akteve të organeve tatimore dhe konstatoi se vlera e shpenzimeve të analizës financiare duhet të rritet me vlerën e detyrimeve tatimore të paguara në këtë vit, si pasojë e spostimit të tyre në vlerën (+) 116.390 lekë.

**18.2** Subjekti pretendon se edhe për këtë vit nuk janë të sakta përllogaritjet e Komisionit për kostot e jetesës dhe shpenzimet e udhëtimit. Edhe në këtë vit, në referim të arsyetimit të kryer më sipër, në paragrafët 11.4 e 11.5 e nënparagrafët e tyre, lidhur me përllogaritjen e shpenzimeve të subjektit të rivlerësimit për kostot e jetesës, trupi gjykues i Kolegjit, në analizën për vitin 2016, bazuar në numrin e anëtarëve të familjes së subjektit të rivlerësimit, i konsideroi këto shpenzime në vlerën 940.368 lekë, përllogaritur sipas të dhënave të INSTAT-it, të përcjella në Kolegj nga ILDKPIKI-ja, përkundër vlerës 696.607 lekë, të përllogaritur nga Komisioni. Nga sa më sipër, rezulton se në analizën e Komisionit, referuar kostove të jetesës, analiza e Komisionit në zërin “shpenzime” për vitin 2016 duhet të rritet me (+) 243.761 lekë. Sa u përket kostove për udhëtimet e kryera në vitin 2016, bazuar në të dhënat e sistemit TIMS për këtë vit, të administruara gjatë hetimit administrativ, trupi gjykues i Kolegjit përllogariti këto shpenzime bazuar në metodologjinë e aplikuar prej tij, të shpjeguar në nënparagrafin 11.5.3. Nga kjo analizë rezultoi se shpenzimet e udhëtimit për këtë vit ishin në vlerën 634.019 lekë, gjë e cila passjell uljen e vlerës së shpenzimeve të udhëtimit të analizës së Komisionit të vitit 2016 me (-)185.717 lekë.

**18.3** Për vitin 2016, subjekti i rivlerësimit parashtron në ankim se në analizën financiare të Komisionit për vitin 2016, janë vendosur “shpenzime arredimi” në masën 500.000 lekë, të cilat ai nuk i ka deklaruar se i ka kryer. Referuar deklarimeve periodike të pasurisë, trupi gjykues i Kolegjit konstaton se për vitin 2016, subjekti i rivlerësimit nuk ka deklaruar asnjë shpenzim mobilimi. Gjithashtu, trupi gjykues konstaton se përgjatë hetimit administrativ në Komision për shpenzimet e mobilimit, subjekti i rivlerësimit ka shpjeguar<sup>61</sup> dhe ka paraqitur fatura tatimore të blerjes së pajisjeve të ndryshme të mobilimit. Asnjë prej tyre nuk provon realizimin e ndonjë shpenzimi për

---

<sup>61</sup>Lidhur me shpenzimet e mobilimit, në përgjigjet e pyetësorit nr. 3, datë 09.10.2018, subjekti ka deklaruar: “[...] Gjatë vitit 2015 është shpenzuar shuma prej 707.828 (shtatëqind e shtatë mijë e tetëqind e njëzet e tetë) lekësh. Si burim kanë qenë të ardhurat e disponuara si kursime dhe ato të siguruara gjatë këtij viti. Gjatë vitit 2016 nuk janë kryer shpenzime. Gjatë vitit 2017 rezulton se është shpenzuar shuma prej 831.460 (tetëqind e tridhjetë e një mijë e katërqind e gjashtëdhjetë) lekësh. Si burim kanë qenë të ardhurat e disponuara si kursime dhe ato të siguruara gjatë këtij viti. Gjithashtu, në fillim të vitit 2018, është shpenzuar edhe shuma e rreth 150.000 (njëqind e pesëdhjetë mijë) lekëve, si burim kanë qenë të ardhurat e disponuara si kursime dhe ato të siguruara gjatë këtij viti [...]”.



mobilitet në vitin 2016. Për këtë arsye, trupi gjyqësor i Kolegjit konsideroi të nevojshëm korrektimin e analizës së vitit 2016, duke ulur zërin “shpenzime” me vlerën (-) 500.000 lekë.

**18.4** Në lidhje me pretendimin e subjektit të rivlerësimit për ndryshimin e likuiditeteve për vitin 2016, trupi gjyqësor i Kolegjit konstaton se në analizën e Komisionit janë përfshirë si likuiditete në *cash* vlera (+) 500.000 lekë. Në kushtet kur subjektet e rivlerësimit nevojitet të deklarojnë në deklaratat periodike të pasurisë çdo shtim apo pakësim të likuiditeteve në gjendje *cash*, trupi gjyqësor i Kolegjit mori në analizë deklaratën periodike të pasurisë të vitit 2016, ku konstatoi se subjekti i rivlerësimit atë vit nuk ka deklaruar asnjë shtesë të likuiditeteve në *cash*<sup>62</sup>. Për këto arsye, trupi gjyqësor i Kolegjit vlerësoi se analiza e detajuar e Komisionit për vitin 2016 është e gabuar dhe duhet të korrektohet duke mos përfshirë në të si ndryshim likuiditeti në *cash* shumë prej 500.000 lekësh.

**18.5** Në përfundim, për analizën e vitin 2016 të kryer nga Komisioni, sipas së cilës subjekti i rivlerësimit ka rezultuar me situatë negative të mbulimit të shpenzimeve e kursimeve me burime të ligjshme në vlerën (-)170.634 lekë, trupi gjyqësor i Kolegjit çmon se, duke konsideruar të gjitha konkluzionet e mësipërme, kjo analizë duhet korrigjuar përkatesisht: duke rritur shpenzimet me vlerën (+) 243.761 lekë për kostot e jetesës dhe duke ulur shpenzimet e udhëtimit me vlerën (-) 185.717 lekë; duke rritur shpenzimet e aktivitetit noterial të bashkëshortes në vlerën 116.390 lekë nga tatimet e spostuara; si dhe duke korrigjuar ndryshimin e likuiditeteve në vlerën (-) 500.000 lekë. Në total të sa më sipër, për vitin 2016, situata financiare e subjektit të rivlerësimit, pas analizës së kryer në Kolegj, rezulton me situatë pozitive të mbulimit të shpenzimeve me të ardhura të ligjshme në masën (+) 656.911 lekë.

- 19** Në përfundim të shqyrtimit të pretendimeve të subjektit të rivlerësimit në drejtim të kontrollit të pasurisë dhe duke u ndalur në ato vite për të cilat subjekti i rivlerësimit ka paraqitur kundërshtime nëpërmjet ankimit objekt gjykimi, trupi gjyqësor i Kolegjit, edhe pas kryerjes së një analize financiare objektive dhe garantiste, bazuar në kërkesat e ligjit të zbatueshëm, në mënyrë të veçantë në nenin 49, pika 4 e ligjit nr. 84/2016, ku parashikohet se: *[...] Komisioni dhe Kolegji i Apelit e bazojnë vendimin e tyre vetëm në dokumentet nga burime të njohura, në prova të besueshme ose që janë në pajtueshmëri të dukshme me provat e tjera. Ata kanë të drejtë të çmojnë, sipas bindjes së tyre të brendshme, çdo indicie në tërësi lidhur me rrethanat e çështjes [...]*, si dhe në nenin 51 të ligjit nr. 84.2016, që parashikon se: *Në rast se subjekti i rivlerësimit nuk paraqet provat, sipas nenit 85 të Kodit të Procedurave Administrative, si dhe kur provat që disponojnë janë të paplota, Komisioni ose Kolegji i Apelit mund të vendosin bazuar në provat që disponojnë, në vlerësimin e çështjes në tërësi, si dhe në bindjen e tyre të brendshme*, konkludoi se edhe duke pranuar edhe pretendimet e pranuar nga Komisioni, të cilat nuk janë pasojë e një hetimi të thelluar, apo mbetën në nivel deklarativ, subjekti i rivlerësimit gjendet gjithsesi në kushtet e mungesës së burimeve të ligjshme për të justifikuar pasuritë dhe mbuluar shpenzimet, me rezultatet sa më poshtë.
- Në vitin 2005, ka mungesë të burimeve të ligjshme në masën (-)120.346 lekë.
  - Në vitin 2007, ka mungesë të burimeve të ligjshme në masën (-)709.429 lekë.
  - Në vitin 2008, ka mungesë të burimeve të ligjshme në masën (-)118.867 lekë.
  - Në vitin 2010, ka mungesë të burimeve të ligjshme në masën (-)135.611 lekë.

---

<sup>62</sup> Subjekti ka deklaruar se ka shtuar 500.000 lekë në llogarinë rrjedhëse të pagës në “Raiffeisen Bank” Durrës, të kursyera nga paga e tij, nga të ardhurat në vitin 2016. Ka deklaruar se është shtuar shuma në lekë nga të ardhurat vjetore të bashkëshortes si notere në vitin 2016, me vlerën 1.360.000 lekë, e këmbyer në shumën 10.000 euro, derdhur në llogarinë rrjedhëse në Intesa Sanpaolo Bank. Po ashtu është deklaruar se shuma e disponuar në *cash* në euro, e deklaruar për vitin 2015, mbetet e pandryshuar.

Për periudhën 2003-2016, subjekti i rivlerësimit rezulton me mungesë të burimeve të ligjshme për krijimin e pasurive dhe mbulimin e shpenzimeve, në vlerën totale prej (-) 1.084.253 lekësh. Kjo situatë faktike, bazuar edhe në analizën në tërësi të gjithë elementeve që përbejnë kontrollin e kriterit pasuror, duke pranuar mangësitë në hetimin e Komisionit, e çon trupin gjykues të Kolegjit drejt vlerësimit se subjekti i rivlerësimit ndodhet në kushtet e mungesës së burimeve të ligjshme, sipas parashikimit të nenit 33, pika 5, germa “b” e ligjit nr. 84/2016.

- 20 Në përfundim, mbështetur në konkluzionin e mësipërm, trupi gjykues i Kolegjit çmon se subjekti i rivlerësimit ka kryer deklarin të pamjaftueshëm në lidhje me kriterin e kontrollit të pasurisë, sipas parashikimit të nenit D, pika 3 e Aneksit të Kushtetutës, si dhe nenit 61, pika 3 e ligjit nr. 84/2016 dhe, për këtë arsye, gjendet e drejtë masa disiplinore e shkarkimit të tij nga detyra, e dhënë me vendimin e Komisionit nr. 138, datë 09.04.2019.

### **PËR KËTO ARSYE,**

trupi gjykues i Kolegjit, bazuar në nenin 66, pika 1, germa “a” e ligjit nr. 84/2016 “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve e prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”,

### **VENDOSI:**

1. Lënien në fuqi të vendimit nr. 138, datë 09.04.2019, të Komisionit të Pavarur të Kualifikimit që i përket subjektit të rivlerësimit Ferdinand Elezi.
2. Ky vendim është përfundimtar dhe ka efekt të menjëhershëm.

U shpall në Tiranë, më datë 30.9.2020.

#### **ANËTARE**

**Natasha MULAJ**

*nënshkrimi*

#### **ANËTAR**

**Ardian HAJDARI**

*nënshkrimi*

#### **ANËTARE**

**Rezarta SCHUETZ**

*nënshkrimi*

#### **RELATORE**

**Ina RAMA**

*nënshkrimi - kundër*

#### **KRYESUESE**

**Albana SHTYLLA**

*nënshkrimi - kundër*

## MENDIM PAKICE

1. Ne, gjyqtaret Ina Rama e Albana Shtylla, kemi votuar kundër vendimit të dhënë nga shumica e trupit gjykues për çështjen që i përket ankimit të subjektit të rivlerësimit Ferdinand Elezi kundër vendimit nr. 138, datë 09.04.2019, të Komisionit të Pavarur të Kualifikimit, duke votuar për ndryshimin e këtij vendimi dhe konfirmimin në detyrë të subjektit të rivlerësimit.
2. Siç rezulton nga vendimi i shumicës për këtë çështje, subjekti është konsideruar se gjendet në kushtet e mungesës së burimeve të ligjshme për të përballuar krijimin e pasurive dhe kryerjen e shpenzimeve në vitet 2005, 2007, 2008 e 2010, sipas parashikimit të nenit 33, pika 5, germa “b” e ligjit nr. 84/2016 në vlerën prej 1.084.253 lekësh, dhe kjo rrethanë faktike e ligjore përbën deklaram të pamjaftueshëm për kriterin e kontrollit të pasurisë, sipas parashikimit të nenit 61, pika 3 e ligjit nr. 84/2016, parashikim i cili përcakton edhe vendosjen e masës disiplinore të shkarkimit nga detyra të subjektit të rivlerësimit, duke konkluduar për pasojë në lënien në fuqi të vendimit të Komisionit objekt shqyrtimi.
3. Pakica ka ndarë të njëjtin qëndrim me shumicën për sa i përket analizës financiare të kryer në Kolegj për llogari të këtij procesi, të mbështetur mbi aktet e administruara nga hetimi administrativ i kryer në Komision dhe në reflektim të shkaqeve të ankimit të paraqitura nga subjekti i rivlerësimit. Në kryerjen e kësaj analize, Kolegji me të drejtë i është referuar juridiksionit të tij kushtetues, në përputhje me parashikimin e nenit F, pikat 1 dhe 3 të Aneksit të Kushtetutës, si një gjykatë e juridiksionit të zakonshëm, e cila zbaton në gjykim rregullat dhe parimet e gjykimit të drejtë, të mbështetur edhe në parimet e procesit të rregullt të parashikuar nga neni 6 i KEDNj-së dhe neni 42 i Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, duke vlerësuar çdo pretendim të paraqitur në ankimin e subjektit në konsideratë të parimit gjyqësor të parashikuar nga neni 6 i Kodit të Procedurës Civile, sipas të cilit: *Gjykata që gjykon mosmarrëveshjen, duhet të shprehet mbi gjithçka që kërkohet dhe vetëm për atë që kërkohet*, dhe nga neni 465, paragrafi 1 i Kodit të Procedurës Civile, që parashikon se Gjykata e Apelit shqyrton çështjen brenda kufijve të ankimit, si edhe në konsideratë të parimit të gjykimit në shkallë të dytë të çështjeve me natyrë administrative, *no reformatio in peius*, të parashikuar nga neni 137, pika 5 e Kodit të Procedurave Administrative, në të cilin përcaktohet se: *Nëse nuk është parashikuar ndryshe nga ligji, akti i organit epror mund të jetë vetëm në dobi të palës ankuese*.
4. Në përfundim të kësaj analize, ka rezultuar, siç pranohet edhe në vendimin e shumicës, se subjekti i rivlerësimit ka qenë në kushtet e mungesës së burimeve të ligjshme për të justifikuar pasuritë e përballuar shpenzimet e kryera në vitet 2005, 2007, 2008 e 2010 dhe ky fakt ka përbërë, sipas vendimmarrjes së shumicës, bazën e duhur faktike e ligjore për shkarkimin e tij nga detyra e, për pasojë, lënien në fuqi të vendimit të Komisionit.
5. Më këtë konkluzion të shumicës, ne gjyqtaret në pakicë nuk kemi qenë dakord dhe kemi votuar kundër. Sipas vlerësimit tonë, shkelja e konstatuar e ligjit që lidhet me vlerën që ka përfaqësuar mungesën e burimeve të ligjshme për subjektin e rivlerësimit, nuk duhet të konsiderohej si një shkelje e cila qëndronte në proporcion të drejtë me masën disiplinore të shkarkimit nga detyra të magjistratit në kuptim të këtij procesi, por në zbatim të parashikimeve ligjore të kuadrit ligjor në fuqi, do të duhet të konsiderohej jo mjaftueshëm për vendosjen e masës disiplinore të shkarkimit nga detyra.

6. Para së gjithash, në vlerësimin e pakicës, vlen të arsyetohet dhe elaborohet koncepti dhe zbatimi i disa parimeve të rëndësishme të procesit të rivlerësimit, që gjejnë vend posaçërisht për t'u zbatuar në këtë çështje, për shkak të një sërë rrethanash që do të zhvillohen në arsyetimin në vijim.
7. Procesi i rivlerësimit kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë është një proces i parashikuar në Kushtetutë, me qëllim që të garantohet funksionimi i shtetit të së drejtës dhe pavarësia e sistemit të drejtësisë, si edhe rikthimin e besimit të publikut tek institucionet e drejtësisë, sipas parashikimit të nenit 179/b, pika 1 e Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë.  
Ky proces administrativ dhe gjyqësor, me tipare kushtetuese dhe administrative, zhvillohet nga organet e rivlerësimit në zbatim të disa parimeve thelbësore, që përfaqësojnë elementet e procesit të rregullt sipas parashikimit të nenit 179/b, pika 2 e Kushtetutës, si edhe parashikimeve të nenit 4, pika 5 e ligjit nr. 84/2016, sipas të cilit: *Komisioni dhe Kolegji i Apelit ushtrojnë funksionet e tyre si institucione të pavarura dhe të paanshme, mbi bazën e parimeve të barazisë përpara ligjit, të kushtetutshmërisë e ligjshmërisë, të proporcionalitetit dhe të parimeve të tjera që garantojnë të drejtën e subjekteve të rivlerësimit për një proces të rregullt ligjor.*
8. Të njëjtin rregull gjejmë të sanksionuar edhe në nenin 52, pika 1 e ligjit nr. 84/2016, që orienton organet e rivlerësimit që në shqyrtimin e çështjeve të udhëhiqen nga parimet e objektivitetit dhe proporcionalitetit, dy parime që krahas parimit për t'u njohur me aktet e për t'u dëgjuar e mbrojtur të subjektit të rivlerësimit, rezultojnë t'i japin procesit të rivlerësimit tiparet e një procesi administrativ përgjatë zhvillimit të tij nga Komisioni dhe të një gjykimi administrativ e kushtetues përgjatë zhvillimit të tij në Kolegji, që garanton dhe mbron të drejtat e palëve, siguron një balancë të mirorientuar mes shkeljeve të konstatuara dhe sanksioneve përkatëse, duke arritur në këtë mënyrë të realizojë qëllimin e shpallur në nenin 179/b, pika e 1 e Kushtetutës për funksionimin e shtetit të së drejtës dhe rikthimin e besimit të publikut te sistemi i drejtësisë.
9. Sipas parashikimit kushtetues që gjen pasqyrim në nenin D të Aneksit të Kushtetues, e që lidhet me përdorimin e standardeve të provueshmërisë së ligjshmërisë së burimeve për krijimin e pasurisë në nivelin “bindshëm” apo parashikimit më tej të standardit “nivel i besueshëm i vlerësimit të pasurisë” në nenin 59, pika 1, germa “a” e ligjit nr. 84/2016, organet e rivlerësimit, përfshi Kolegjin e Posaçëm të Apelit, kanë një pushtet diskrecionar, tipik të pushtetit të organeve publike në proceset administrative apo gjykata administrative që kontrollojnë veprimtarinë administrative, që i lejon këto organe të vlerësojnë rast pas rasti zbatimin e parimeve të cituara më lart.
10. Parimi i proporcionalitetit dhe i objektivitetit janë dy parime të rëndësishme që duhet të shoqërojnë dhe karakterizojnë procesin e rregullt ligjor, posaçërisht në procedurat administrative e gjykimet administrative apo ato me karakter publik e kushtetues, në të cilat organet publike ose gjykatat që gjykojnë mbi ligjshmërinë e një veprimi administrativ, vlerësojnë dhe balancojnë të drejtat e individit dhe interesin publik në raport me rëndësinë e shkeljes së konstatuar, në kuptim të parashikimeve të KEDNJ-së dhe jurisprudencës së GjEDNJ-së<sup>63</sup>, si dhe *udhëzimit mbi nenin 14 të*

<sup>63</sup> *Shih vendimin e GjEDNJ-së për çështjen Molla Sali v. Greece 19.12.2018, tek i cili, në paragrafin 135, kjo gjykatë shpreh se :*

*Për qëllimet e nenit 14, një ndryshim i trajtimit është diskriminues nëse "nuk ka justifikim objektiv dhe të arsyeshëm", domethënë nëse nuk ndjek një "qëllim të ligjshëm" ose nëse nuk ka një "marrëdhënie të arsyeshme të proporcionalitetit" midis mjeteve të përdorura dhe qëllimit që kërkohet të realizohet.*

*Në vendimin e GjEDNJ-së FABRIS v. FRANCE, datë 7.02.2013, në paragrafin 56, kjo gjykatë shpreh se :*

*"56. Për qëllimet e nenit 14, një ndryshim i trajtimit është diskriminues nëse "nuk ka një justifikim objektiv dhe të arsyeshëm", domethënë, nëse nuk ndjek një "qëllim legjitim" ose nëse nuk ka një "marrëdhënie të arsyeshme të proporcionalitetit midis mjeteve të përdorura dhe qëllimit që kërkohet të realizohet" (shih Mazurek, cituar më lart, §§ 46 dhe 48). Për më tepër, shtetet kontraktuese gëzojnë një marzh të caktuar vlerësimi lidhur me çmimin se çfarë*

*KEDNj-së dhe nenin 1 të Protokollit nr. 12 të Konventës, faqja 15-19: “[...] Në vlerësimin nëse ka pasur diskriminim, gjykata do të aplikojë testin e mëposhtëm, ndër të tjera duhet të aplikojë edhe testin [...] A janë mjetet e përdorura arsyeshëm proporcionale me qëllimin e synuar?”.*

11. Në legjislacionin tonë gjejmë të definuar kuptimin e këtyre dy parimeve në Kodin e Procedurave Administrative, respektivisht në nenin 12<sup>64</sup> parimin e proporcionalitetit dhe në nenin 14<sup>65</sup> parimin e objektivitetit.
12. Duke ndjekur dhe zbatuar këto dy parime në shqyrtimin e një çështjeje gjatë procesit të rivlerësimit, sipas autorizimit të nenit 4, pika 5 dhe nenit 52, pika 1 e ligjit nr. 84/2016, gjykata e procesit, në këtë rast Kolegji, duhet të analizojë e vlerësojë efektin apo pasojën që duhet të prodhojë një shkelje e caktuar e ligjit, duke vlerësuar njëkohësisht rrethanat në të cilat shkelja rezulton se është kryer dhe garantimin e interesit publik apo të të drejtave të të tjerëve, në përcaktimin e masës disiplinore si pasojë. Duke qenë se në përfundim të këtij procesi, alternativat e gjykatës për vendosjen e një mase disiplinore janë të kufizuara (janë vetëm dy masa sipas parashikimit të ligjit, shkarkimi nga detyra ose pezullimi me afat njëvjeçar për efekt të ndjekjes së programit trajnues në Shkollën e Magjistraturës), aq më shumë gjykata duhet të jetë e vëmendshme në aplikimin e vlerësimit e çështjeve të procesit nën frymën e këtyre parimeve, për të garantuar zhvillimin e një procesi të rregullt e dhënien e një vendimi të drejtë.
13. Nën frymën e këtyre parimeve, si edhe të diskrecionit që lejon neni D i Aneksit të Kushtetutës, pakica vlerësoi mungesën e burimeve të ligjshme të subjektit të rivlerësimit, në këndvështrim të rrethanave faktike e ligjore që kanë prodhuar atë e në raport me masën disiplinore të shkarkimit nga detyra, duke e gjetur këtë fundit joproporcionale<sup>66</sup> dhe jo të drejtë në rastin konkret.
14. Siç pasqyrohet edhe nga arsyetimi i vendimit të shumicës, situata financiare e subjektit të rivlerësimit ka rezultuar me mungesa të burimeve të tij financiare në vitet dhe vlerat si vijojnë.
  - Në vitin 2005, ka mungesë të burimeve të ligjshme në masën (-)120.346 lekë.
  - Në vitin 2007, ka mungesë të burimeve të ligjshme në masën (-)709.429 lekë.
  - Në vitin 2008, ka mungesë të burimeve të ligjshme në masën (-)118.867 lekë.
  - Në vitin 2010, ka mungesë të burimeve të ligjshme në masën (-)135.611 lekë.
15. Nga kjo shpërndarje në vite e diferencave negative për subjektin e rivlerësimit, konstatohet së pari se, me përjashtim të vitit 2007, në të cilin diferenca negative rezulton të jetë në shifrën 709.429 lekë, në tri vitet e tjera, 2005, 2008 e 2010, ajo paraqitet në vlera të ulura, respektivisht, 120.346 lekë; 118.867 lekë dhe 135.611 lekë.
16. Në vlerësimin tonë, diferenca të tilla në rezultatet e analizës financiare të kryer nga organet e rivlerësimit, në të cilën ka ndërthurje edhe të vlerësimit ligjor të të dhënave të përfshira në

---

*ndryshimesh në situata të ngjashme justifikojnë një trajtim të ndryshëm (shih Stec dhe të tjerët, cituar më lart, §§ 51 dhe 52, ECHR 2006-VI).*

<sup>64</sup> 1. Çdo veprim administrativ, i cili, për arsye të mbrojtjes së interesit publik ose të të drejtave të të tjerëve, mund të kufizojë një të drejtë individuale, ose mund të cenojë interesa legjitimë, zhvillohet në përputhje me parimin e proporcionalitetit.

2. Veprimi administrativ është në përputhje me parimin e proporcionalitetit vetëm kur ky veprim është:

- a) i nevojshëm për të arritur qëllimin e përcaktuar me ligj dhe e arrin atë me mjetet dhe masat që cenojnë më pak të drejtat apo interesat legjitimë të palës;
- b) i përshtatshëm për të arritur qëllimin e parashikuar në ligj; dhe
- c) në përpjesëtim të drejtë me nevojën që e ka diktuar atë.

<sup>65</sup> Gjatë ushtrimit të veprimtarisë administrative, organet publike marrin në konsideratë dhe u japin rëndësinë e duhur të gjitha kushteve, të dhënave dhe provave që lidhen me procedurën administrative.

<sup>66</sup> Qëndrim i mbajtur edhe në arsyetimin e mendimit paralel të vendimit të Kolegjit nr. 3/2020 (JR), datë 04.03.2020.

përmbajtjen e saj, e cila tashmë është konsideruar si një mekanizëm vlerësimi me natyrë jo vetëm matematikore, analitike e logjike, por edhe jo krejtësisht realiste, për sa kohë mbështeten në rrethana të cilat vlerësohen se kanë ekzistuar në bazë të aftësisë së subjekteve për të provuar të kundërtën e tyre apo se ato rrethana kanë ekzistuar në një mënyrë apo masë të ndryshme, por që pavarësisht këtij standardi ligjor mund të mos kenë qenë të tilla për subjektin, duhen konsideruar si irelevante për të vlerësuar realisht mundësinë e subjektit për provimin e ligjshmërisë së burimeve të ligjshme.

17. Për më tepër, analiza financiare e subjektit për këto vite, 2005, 2008 e 2010, dominohet kryesisht nga ndryshueshmëria/diversiteti i të ardhurave të bashkëshortes si person fizik “notere”, dhe nga shpenzime përgjithësisht të kryera për jetesën e jo për ndonjë investim në pasuri, me përjashtim të automjetit të blerë në vitin 2010, por që nuk prodhon efekt në analizën financiare të këtij viti, duke qenë se përdoren paratë e fituara nga shitja e një automjeti të mëparshëm për të blerë të riun.

18. Pakica gjithashtu vlerëson se edhe vlera e diferencës negative që ka rezultuar për vitin 2007, në masën prej 709.429 lekësh, duhet t’i nënshtrohet një analize objektive për të kuptuar realisht peshën e kësaj diference në drejtim të standardit kushtetues për të provuar bindshëm burimin e krijimit të pasurive.

Në radhë të parë, vlen të përmendet fakti se ky rezultat i analizës financiare kushtëzohet në një vlerë të konsiderueshme nga fakti që shpenzimet e jetesës për këtë vit kalendarik, referuar shkresës së përcjellë në Kolegj nga IIDKPKI-ja<sup>67</sup> kanë një rritje të paarsyeshme e të palogjikshme krahasuar me vitet pararendëse e pasardhëse. Sipas kësaj praktike të referuar në Kolegj, shpenzimet e jetesës për familjen e subjektit të rivlerësimit, si edhe për çdo subjekt tjetër do të llogariten në vitin 2006 në vlerën 328.671 lekë; në vitin 2007 në vlerën 466.897 lekë; dhe në vitet 2008-2011 në vlerën 546.480 lekë. Përcaktimi i këtyre vlerave, ndonëse i përgjigjet një standardi të referuar nga organi kompetent dhe i përdorur në analizën financiare si një standard ligjor, nuk mund të mos jetë i vlerësueshëm prej organeve të rivlerësimit si jo bindës për një standard real, kur ai afekton analizën financiare të subjekteve në këta terma.

Pra, në rrethanat kur për shkak të vlerave të caktuara të diferencave negative në analizën financiare, organet e rivlerësimit kryejnë një analizë e vlerësim të këtyre diferencave në raport me të gjithë shqyrtimin e vlerësimitin e çështjes, kjo rritje e shpenzimeve të jetesës në vitin 2007, në mënyrë të shkëputur e të paharmonizuar me logjikën e kurbës për shpenzimet e jetesës për vitet në vazhdim, në të cilat për subjektet vazhdojnë të aplikohen vlera shumë më të ulura të këtyre shpenzimeve, duhet konsideruar me rezervë dhe vlerësuar në kontekstin e përgjithshëm të të gjitha rrethanave të çështjes.

19. Në këtë vlerësim, duhet të konsiderohet edhe fakti që Kolegji mori si të mirëqenë për këtë vit (vitin 2007) vlerat për shpenzimet e udhëtimit të përcaktuara nga Komisioni, në pamundësi të verifikimit ekzaktësisht të hyrjeve e daljeve të subjektit prej sistemit TIMS, për shkak të mospasqyrimin të plotë e të saktë në këtë sistem të të gjitha lëvizjeve të subjektit jashtë vendit, duke pasqyruar në analizë një vlerë për shpenzimet e udhëtimit, e cila mund të jetë ndoshta më e lartë se ajo që është shpenzuar realisht nga subjekti i rivlerësimit. Për pasojë, vlerësimi i këtyre shpenzimeve mbeti teorik dhe i pashqyrtuar në të gjithë vlerën e tij dhe i pamundur që t’i

<sup>67</sup> Nga ana e Kolegjit, përlllogaritja e kësaj vlere që u korrespondon kostove të jetesës, është bërë duke iu referuar të dhënave bazë për: Konsumin vjetor për frymë dhe numrin e personave të njësisë familjare.

Të dhënat për konsumin vjetor për frymë, nga Kolegji, janë marrë nga INSTAT-i, përkatësisht:

- për vitin 2006, nga anketa e matjes së nivelit të jetesës (LSMS 2005);
- për vitin 2007, nga anketa e buxhetit të familjes (ABF 2006-2007);
- për periudhën 2008- 2011, nga anketa e matjes së nivelit të jetesës (LSMS 2008).

nënshtrohej zbatim të metodologjisë së përdorur në Kolegj për llogaritjen e shpenzimeve të udhëtimit, duke marrë në këtë mënyrë natyrën e vlerësimit subjektiv.

20. Në mënyrë të posaçme, në këtë çështje, pakica vlerëson të veçojë të ardhurat e subjektit të krijuara nga aktiviteti noterial i bashkëshortes së tij. Nga ajo që kuptohet nga leximi i deklaratave periodike dhe dokumentacionit të përcjellë nga Drejtoria Rajonale Tatimore Durrës, rezulton se bashkëshortja e subjektit ka zhvilluar një aktivitet noterial të dendur, që i ka prodhuar të ardhura të konsiderueshme e me rend konstant në vite<sup>68</sup>. Duke konsideruar natyrën e këtij aktiviteti, në të cilin veprimtaria e personit juridik si person fizik, është e vështirë të ndahet qartazi nga aktiviteti dhe administrimi i këtij aktiviteti prej individit, që në këtë rast është vetë noteri, posedimi dhe përdorimi i shumave apo të ardhurave të krijuara nga ky aktivitet, shpesh herë natyrshëm marrin formën e likuiditeve që vihen në shërbim të përballimit të shpenzimeve familjare, edhe pa u evidentuar si të tilla në librat apo evidencat financiare të vetë personit fizik. Kjo veçori e këtij aktiviteti e bën të vështirë ndarjen e saktë dhe matematikore të të ardhurave të deklaruara e të krijuara realisht, në raport me shpenzimet që kryhen për mbajtjen e administrimit të këtij aktiviteti, të cilat mund të ndodhë që praktikisht të jenë më të vogla se ato të deklaruara edhe për shkak të respektimit të standardeve financiare që imponon legjislacioni tatimor në Republikën e Shqipërisë.
21. Nga deklarimi i personit të lidhur në deklaratat periodike e analizimi i bilanceve financiare të aktivitetit, rezultojnë deklarime që flasim për të dhëna jo shumë qartë të kuptueshme, të cilat së paku flasin për një mundësi teorike të posedimit të një *cash flow* nga ana e personit të lidhur, të vështirë për t'u përcaktuar ekzaktësisht, por të përdorur sipas nevojave personale. Në këtë kontekst, pakica ka në konsideratë deklaratimet në bilancet e disa viteve të një vlere të konsiderueshme<sup>69</sup>, që përcaktohet si vlera që i korrespondon zërit "amortizim", pa u lidhur kjo vlerë me ndonjë objekt apo pasuri të caktuar së cilës t'i korrespondojë. Pretendimi i subjektit se kjo vlerë në të vërtetë ka përfaqësuar një sasi likuiditeti, i cili nuk është përdorur realisht për të përballuar asnjë shpenzim me natyrë amortizuese, por është përdorur për nevojat e ekonomisë familjare, mbeti një pretendim i

---

<sup>68</sup> Nga aktet e administruara përgjatë hetimit administrativ, të ardhurat ndër vite të aktivitetit noterial të bashkëshortes së subjektit të rivlerësimit rezultojnë si vijojnë.

- Për vitin 2007, të ardhura nga aktiviteti noterial 2.278.805 lekë.
- Për vitin 2008, të ardhura nga aktiviteti noterial 3.018.194 lekë.
- Për vitin 2009, të ardhura nga aktiviteti noterial 2.815.113 lekë.
- Për vitin 2010, të ardhura nga aktiviteti noterial 1.486.697 lekë.
- Për vitin 2011, të ardhura nga aktiviteti noterial 1.638.113 lekë.

Në drejtim të të ardhurave të deklaruara nga aktiviteti noterial nga bashkëshortja e subjektit të rivlerësimit, nga aktet e administruara rezulton se këto të ardhura nga aktiviteti i saj kanë qenë në shifra të konsiderueshme edhe para se të lidhte martesë me subjektin e rivlerësimit, me vlerat si vijojnë.

- Viti 2000 – 834.175 lekë.
- Viti 2001 – 1.587.650 lekë.
- Viti 2002 – 3.750.000 lekë.
- Viti 2003 – 1.178.000 lekë.
- Viti 2004 - 1.060.695 lekë.

<sup>69</sup> Referuar pasqyrave financiare, amortizimi rezulton në vlerat si vijojnë.

- Për vitin 2010, në shumën 7.500 lekë.
- Për vitin 2011, në shumën 150.366 lekë.
- Për vitin 2012, në shumën 244.877 lekë.
- Për vitin 2013, në shumën 262.475 lekë.
- Për vitin 2014, në shumën 240.386 lekë.
- Për vitin 2015, në shumën 258.698 lekë.
- Për vitin 2016, në shumën 254.202 lekë.

Vlera e amortizimit për të gjitha këto vite, ka një total prej 1.418.504 lekësh.

paprovuar, por që në vlerësimin tonë si pakicë, vlen të konsiderohet për të përshkruar natyrën e administrimit të likuiditeteve në një aktivitetet të kësaj natyre dhe për t'u vlerësuar në vlerësimin e përgjithshëm që i bëhet diferencës negative të konkluduar për subjektin e rivlerësimit në termat e këtij vendimi.

22. Në të njëjtën frymë vlerësohet prej pakicës edhe deklarimi i personit të lidhur në deklaratën e pasurisë *vetting* në lidhje me të ardhurat e krijuara nga aktiviteti noterial, duke përfshirë në to edhe ato të ardhura të përdorura për të përballuar kredinë bankare të marrë nga bashkëshortja e subjektit në Bankën Intesa San Paolo, për blerjen e zyrës noteriale, të cilat në analizën financiare të kryer janë llogaritur si shpenzime të nxjerra nga njësia familjare, kur ndërkohë, në pasqyrat financiare, ka të dhëna që këto shpenzime për këtë kredi janë mbuluar nga fondet e aktivitetit noterial. Ndonëse kjo e dhënë nuk ka afektuar analizën financiare të subjektit, pasi në vitet respektive<sup>70</sup> analiza financiare ka rezultuar pozitive dhe konsiderimi i kësaj rrethane thjesht do të rriste balancën pozitive, por nuk do të ndryshonte vlerësimin e përgjithshëm për subjektin, pakica vlerëson të evidentojë këtë rrethanë për të nënvizuar faktin e pasigurisë në rezultatin e analizës financiare për subjektin e rivlerësimit, për sa kohë konstatohet që pjesa më e rëndësishme e të ardhurave të familjes buron nga një aktivitet i cili nuk garanton siguri maksimale të përlllogaritjes së të ardhurave dhe shpenzimeve të kryera e, për pasojë, edhe të fitimit të mbetur përfundimisht. Të tria këto elemente, në një aktivitet të kësaj natyre, e bëjnë nxjerrjen e rezultatit të analizës financiare të diskutueshëm e jo shumë të sigurt, siç do të ishte nëse të ardhurat e njësisë familjare do të vinin për shkak të marrëdhënieve të punës, veçanërisht ato të lidhura me ente publike e institucione shtetërore.
23. Për shkak të gjithë argumenteve të mësipërme, pakica ka vlerësuar se diferenca negative e konstatuar nga analiza financiare e kryer në Kolegj për subjektin e rivlerësimit, duhet të çmohet në raport me të gjitha rrethanat e përshkruara më lart, për të përcaktuar në mënyrë sa më proporcionale ndikimin që kjo shkelje do të duhet të ketë në vendosjen ose jo të masës disiplinore të shkarkimit nga detyra të subjektit të rivlerësimit.
24. Në konsideratë të këtij arsytimi, ne kemi vlerësuar se pavarësisht kësaj mungese të burimeve financiare, për subjektin e rivlerësimit, të shpërndarë në vite<sup>71</sup> në vlerat e përshkruara më lart, dhe të mbetura si e vetmja arsye mbi të cilat diskutohet vendosja ose jo e masës disiplinore, duke qenë se për subjektin nuk ekzistojnë shkelje të tjera të ligjit të cilat prezumojnë vendosjen e masës disiplinore të parashikuar nga neni 61 i ligjit nr. 84/2016, kjo diferencë, kryesisht e konstatuar në vitin 2007, nuk justifikon vendosjen e masës disiplinore të shkarkimit nga detyra.
25. Pakica vlerëson se, duke e konsideruar këtë shkelje në këndvështrim të rrethanave të cituara më lart dhe në bazë të autoritetit diskrecional të gjykatës për zbatimin e parimeve të objektivitetit dhe proporcionalitetit, subjekti i rivlerësimit e kalon testin e standardit kushtetues të provimit bindshëm të burimeve të ligjshme për krijimin e pasurisë, sipas përcaktimit të nenit D, pika 3 e Aneksit të Kushtetutës dhe gjithashtu gjendet edhe në kushtet e parashikuara edhe nga neni 59, pika 1, germa “a” e ligjit nr. 84/2016, duke arritur në një nivel të besueshëm në vlerësimin e kriterit të pasurisë.
26. Në kushtet kur subjekti i rivlerësimit, sipas vendimit të Komisionit, ka rezultuar se ka një nivel të besueshëm në vlerësimin e kriterit të figurës, sipas nenit 59, pika 1, germa “b” dhe një nivel kualifikues në kriterin e aftësive profesionale, sipas nenit 59, pika 1, germa “c” e ligjit nr. 84/2016,

<sup>70</sup> Në vitet 2012, 2013 dhe 2014.

<sup>71</sup> Diferenca në vitet 2005 në vlerën (-)120.346 lekë; në vitin 2008 në vlerën prej (-) 118.867 lekësh dhe në vitin 2010 në vlerën (-)135.611 lekë, konsiderohen si të papërfillshme për shkak të vlerave që ato kanë.



arrihet në përfundimin se subjekti ka arritur në mënyrë kumulative nivel të besueshëm në vlerësimin e të tria kriterëve të procesit të rivlerësimit dhe, për pasojë, ai duhet të konfirmohet në detyrë, në zbatim të nenit 59, pika 1 e ligjit nr. 84/2016, duke u ndryshuar vendimi nr. 138, datë 09.04.2019, i Komisionit të Pavarur të Kualifikimit, i cili e ka shkarkuar atë nga detyra.

**GJYQTARE**

**Albana SHTYLLA**

*nënshkrimi*

**GJYQTARE**

**Ina RAMA**

*nënshkrimi*